



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM

Nr. 106 , datë 02.08.2019

PËR LEJIMIN E KANDIDIMIT TË ZNJ. ERIS HYSI NË VENDIN VAKANT PËR INSPEKTOR I LARTË I DREJTËSISË, SHPALLUR NGA KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI NË DATËN 01.03.2019

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, i përbërë nga:

Ardian Dvorani	- Kryetar
Vitore Tusha	- Zëvendëskryetare
Arta Marku	- Anëtare
Margarita Buhali	- Anëtare/Relatore
Fatjona Memçaj	- Anëtare
Fatri Islamaj	- Anëtar
Eriol Roshi	- Anëtar

Asistuar nga sekretare **Ermelinda Kadiu**,

Me praninë e Avokates së Popullit, znj. **Erinda Ballanca** dhe përfaqësuesit të Avokatit të Popullit, z. **Enio Haxhimihali**, në cilësinë vëzhguesit të përhershëm të mbledhjeve dhe veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi,

Me praninë e përfaqësuesve të autorizuar të subjekteve të ftuara sipas ligjit për pjesëmarrje, në cilësinë e vëzhguesve, në mbledhjen e Këshillit:

- z. **Bledar Dervishaj**, përfaqësuesit i autorizuar i Presidentit të Republikës, në mbledhjen e datës **24.07.2019 dhe 02.08.2019**, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

KANDIDATE PËR INSPEKTOR I LARTË I DREJTËSISË

Znj. Eris Hysi

OBJEKTI:

Urdhërimi i lejitimit të kandidimit të znj. **Eris Hysi**, në vendin vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, të shpallur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në datën **01.03.2019**.

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

Pasi dëgjoji relatimin e anëtares së Këshillit, znj. **Margarita Buhali**, mendimin e paraqitur nga Avokati i Popullit, znj. **Erinda Ballanca**, në cilësinë e vëzhgueses së përhershme në mbledhjen dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit dhe si bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Në zbatim të nenit 147/d të Kushtetutës dhe të nenit 199 dhe 229 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në datën 01.03.2019, ka shpallur hapjen e procedurës së aplikimeve për vendin vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë.

2. Në përfundim të procedurës së aplikimeve për shprehjen e interesit për kandidim, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka filluar shqyrtimin e aplikimeve të kandidatëve të shoqëruara me dokumentet e paraqitura prej tyre për përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjore të përcaktuara në nenin 199 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

3. Ndërmjet kandidatëve që kanë shprehur interesin për plotësimin e këtij vendi vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, është edhe znj. Eris Hysi.

4. Në zbatim të nenit 147/d dhe 149/d të Kushtetutës dhe të nenit 199, 229, 235 e vijues të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si edhe të pikës 98 të aktit nënligjor normativ, Vendimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në mbledhjen e zhvilluar në datën 05.04.2019, vendosi fillimin e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes të kandidatëve që kanë shprehur interesin për vendin vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë.

5. Në zbatim të nenit 228 të Ligjit nr. 115/2016 dhe të pikave 5, 27 deri 37 dhe 41 të aktit nënligjor normativ, Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 2 datë 15.02.2019 “Për procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion”, si edhe të pikës 4 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, në të njëjtën ditë të mbledhjes së zhvilluar në datën 05.04.2019, është realizuar edhe procedura për caktimin me short manual të relatorëve për secilin nga vendet vakante të krijuara në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë.

6. Sipas rezultatit të shortit manual të realizuar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, lidhur me zgjedhjen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të shpallur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në datën 01.03.2019, relator për ndjekjen e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturave, është caktuar anëtarja e Këshillit, znj. Margarita Buhali.

7. Znj. Eris Hysi, si njëra ndër kandidatët që ka shprehur interesin për vendin vakant të sipërcituar për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, në zbatim të pikës 22 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, është njoftuar me shkrim për tu paraqitur pranë Këshillit për të vijuar me përmbushjen e procedurave të verifikimit të kandidaturës. Njoftimi me shkrim, i kryer në rrugë elektronike në adresën e deklaruar nga vetë kandidatja Eris Hysi, gjendet e administruar në dosjes e kandidates.

8. Në datën 08.04.2019, kandidatja Eris Hysi është paraqitur pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe është pajisur me formularët e deklaramit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së saj. Kryerja e kësaj procedure vërtetohet nga nënshkrimi prej vetë kandidatit të Deklaratës përkatëse, e cila gjendet e administruar në dosjen e kandidatës.
9. Në datën 12.04.2019, kandidatja Eris Hysi ka depozituar në sekretarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi formularë të deklaramit dhe autorizimet përkatëse për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së saj, të cilat gjenden të administruara në dosjen e kandidatës.
10. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e pasurisë, në zbatim të nenit 235 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 60 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 "*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*", me shkresën nr. 265 prot, datë 19.04.2019, Këshilli i ka dërguar ILDKPKI-së listën e kandidatëve dhe personave të lidhur me ta që i nënshtrohen procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit sipas Ligjit nr. 8577/2000 dhe Ligjit nr.115/2016.
11. Bashkëlidhur kësaj shkrese drejtuar ILDKPKI-së, ndërmjet të tjerave, është vendosur edhe Deklarata e nënshkruar nga kandidatja Eris Hysi, ku tregohet se është pajisur me formularët e deklaramit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e procedurës së verifikimit të kandidaturës së saj, si edhe data e nënshkrimit, nga e cila fillojnë të llogariten afatet e përcaktuara nga ligji për përmbushjen e detyrimeve ligjore të kandidatit për procedurën e verifikimit të kandidaturës.
12. Me shkresën nr.2854/4 prot, datë 03.05.2019, ILDKPKI ka informuar Këshillin e Emërimeve në Drejtësi se kandidatja Eris Hysi e ka përmbushur detyrimin e përcaktuar nga pika 2 e nenit 235 të Ligjit nr. 115/2016 për të dorëzuar të plotësuar pranë atij institucioni Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Privatë të Kandidatit për Pozicione të Ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë.
13. ILDKPKI, në zbatim të nenit 235 të ligjit nr.115.2015, të ligjit nr. 9049/2003 dhe ligjit nr. 9367/2005, me shkresën nr. 2/28 prot., datë 30.05.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatës Eris Hysi dhe personat e lidhur me të.
14. Gjithashtu, në funksion të ushtrimit të kompetencave të tij për verifikimin e plotësimin të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, për sa i përket kontrollit të pasurisë, në zbatim të pikës 4 të nenit 229 dhe 235 të ligjit nr. 115/2016, të shkronjës "e" të pikës 20, 24, shkronjës "b" të pikës 60 e vijues të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 "*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*", edhe ky Këshill ka kryer veprimet verifikuese të kërkimit nga subjekte publike dhe private, të të dhënave mbi pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare që ekzistojnë në emër dhe për llogari të kandidatës Eris Hysi dhe personave të lidhur me të.
15. Për realizimin e veprimeve verifikuese të lidhura me kontrollin e pasurisë së kandidatës Eris Hysi, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në datën 17.04.2019, i është drejtuar me kërkesa për informacion institucioneve publike dhe subjekteve private (të cilat janë administruar në dosjen e kandidimit), si vijon:

- a) Institucioneve bankare: (1) Banka Alpha Albania, (2) Banka Amerikane e Investimeve, (3) Banka Credins, (4) Banka e Bashkuar e Shqipërisë, (5) Banka e Kreditit e Shqipërisë, (6) Banka e Parë e Investimeve, (7) Banka Intesa Sanpaolo, (8) Banka Kombëtare Tregtare, (9) Banka Ndërkombëtare Tregtare, (10) Banka Procredit, (11) Banka Raiffeisen, (12) Banka Societe Generale, (13) Banka Tirana dhe (14) Banka Union.
- b) Institucione financiare të licencuara nga Banka e Shqipërisë: (1) Ak-Invest, (2) Albania Leasing, (3) Capital Invest, (4) Easypay sh.p.k, (5) Final sha, (6) Fondi Besa, (7) Iutecredit Albania, (8) Landeslease, (9) M – Pay sh.p.k. (10) NOA sha, (11) Porsche Leasing, (12) Posta Shqiptare, (13) Raiffeisen Leasing, (14) Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit – FAF, (15) Tirana Factoring & Lease, (16) Tranzit sha, (17) Union Financiar Tiranë.
- c) Subjekte financiare të licencuar nga AMF: (1) Fondi i Pensionit Vullnetar Credins Pension, (2) Fondi i Investimit Credins Premium, (3) Fondi i Investimit Raiffeisen Invest Euro, (4) Fondi i Investimit Raiffeisen Prestigj, (5) Fondi i Investimit Raiffeisen Vision, (6) Fondi i Investimit ËVP Top Invest, (7) Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen, (8) Fondi i Pensionit Vullnetar Sigal.
- ç) Institucione të tjera publike si: (1) Agjencia Shtetërore e Kadastrës, (2) DPSHTRR, (3) D.P.Ttetimeve, (4) M.Drejtësisë, (5) OSHEE, (6) QKB, (7) UKT.

16. Në përgjigje të kërkesave për informacion të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, të gjitha institucionet publike dhe subjektet private të treguara në pikën 15 më sipër, kanë dërguar pranë Këshillit përgjigjet përkatëse ku përmbahen të gjitha të dhënat e kërkuara mbi pasuritë e kandidatëve, nëse kanë pasur të tilla për secilin prej tyre, përfshirë edhe kandidaten Eris Hysi.

17. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, në zbatim të nenit 236 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 82 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, me shkresën nr. 111 prot, datë 17.04.2019, Këshilli ka dërguar në Prokurorinë e Përgjithshme për kompetencë formularin e vetëdeklarimit të plotësuar nga kandidatja Eris Hysi sipas ligjit nr. 138/2015.

18. Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr. 1123/68 prot., datë 03.05.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidaten Eris Hysi.

19. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit të kandidatës Eris Hysi, në zbatim të nenit 236 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 84 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, Këshilli i është drejtuar më kërkesë për informacion Drejtorisë së Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (*shkresa nr. 121 prot, datë 17.04.2019*), Shërbimit Informativ të Shtetit (*shkresa nr. 115 prot, datë 17.04.2019*), Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes (*shkresa nr. 119 prot, datë 17.04.2019*) dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme (*shkresa nr. 116 prot, datë 17.04.2019*).

20. Gjithashtu, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në vijim të procedurës së sipërcituar për verifikimin e integritetit, me shkresën nr.352 prot., datë 20.05.2019, i është drejtuar Drejtorisë së Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar me kërkesë për ndihmë administrative

për përpunimin e informacionit të klasifikuar për qëllimet e verifikimit të integritetit të kandidatëve.

21. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar dhe Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme kanë dërguar përgjigjet e tyre, përkatësisht me shkresat *nr. 1545 prot., datë 10.06.2019* dhe *nr. 730/1 prot., datë 20.05.2019*.

22. Gjithashtu, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, në zbatim të nenit 229 dhe 236 të Ligjit nr. 115/2016, të dispozitave të ligjit nr. 45/2015, si edhe në zbatim të pikës 85 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 "*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*", me shkresën nr. 113 prot, datë 17.04.2019, Këshilli ka dërguar formularin e aplikimit përkatës të plotësuar sipas ligjit nga kandidatja Eris Hysi për kompetencë dhe shqyrtim Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.

23. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, me shkresën nr. 550/4 prot., datë 03.05.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidaten Eris Hysi.

24. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, në zbatim të nenit 237 dhe 240 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikave 91-93 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 "*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*", Këshilli ka marrë në shqyrtim dokumentacionin përkatës të depozituar nga vetë kandidatja Eris Hysi në momentin e kandidimit pranë organit të emërtesës që ka shpallur vendin vakant.

25. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 3 e nenit 147/d të Kushtetutës dhe shkronja "dh" e pikës 1 të nenit 199 të ligjit nr. 115/2016, pra që kandidati *të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit*, Këshilli në datën 02.05.2019 i është drejtuar më kërkesë për informacion partive politike, si dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (*shkresa nr. 270 prot., datë 19.04.2019*), duke i bashkëlidhur listat e të gjithë kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë. Në përgjigje të këtyre kërkesave, KQZ dhe parti politike kanë dërguar informacione lidhur me ekzistencën ose jo të të dhënave që do të vërtetonin angazhimin në ndonjë pozicion drejtues në parti politike të secilit prej kandidatëve, përfshirë edhe kandidaten Eris Hysi.

26. Këshilli i ka kërkuar kandidates Eris Hysi që, në zbatim të nenit 199 dhe 237 të ligjit nr. 115/2016, të paraqesë shpjegime me shkrim dhe dokumente shtesë si vërtetime nga sigurimet shoqërore dhe drejtori tatimore lidhur me pagimin e detyrimeve përkatëse sipas llojit të punës së kryer nga kandidatja; vërtetim që nuk ka masë disiplinore në fuqi si dhe deklaram që nuk ka mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit përpara kandidimit. Në datën 23.04.2019, kandidatja Eris Hysi ka paraqitur me shkrim shpjegime dhe dokumente shtesë.

27. Gjithashtu, në datën 03.07.2019, Këshilli i është drejtuar në rrugë elektronike kandidates Eris Hysi me disa pyetje për qëllime të sqarimeve të nevojshme lidhur me të dhëna mbi kushtet e kandidimit. Lidhur me këto pyetje, në datën 05.07.2019, kandidatja Eris Hysi ka paraqitur me shkrim shpjegime dhe dokumente shtesë.

28. Gjithashtu, për këtë rast kandidimi, Këshilli vlerësoi ti drejtohet me kërkesa për informacion disa institucioneve publike ku mund të gjenden të dhëna lidhur me funksione dhe veprimtari private profesionale të ushtruara nga kandidatja Eris Hysi si Instituti i Sigurimeve Shoqërore (shkresa nr. 276 prot, datë 19.04.2019), Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (shkresa nr. 275 prot, datë 19.04.2019) si dhe Drejtoria e Rajonale e Tatimeve Tiranë (shkresa nr. 444 prot, datë 31.07.2019).

29. Lidhur me të dhënat e kërkuara, Këshilli ka marrë përgjigje me shkrim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore (shkresa nr. 4090 prot, datë 09.05.2019 dhe nr. 3079/2 prot, datë 24.04.2019), Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (shkresa nr. 8345/1 prot, datë 15.05.2019) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (shkresa nr. 14775/3/1 prot, datë 01.08.2019).

30. Në përfundim të veprimeve dhe procedurave të kontrollit dhe verifikimit, në zbatim të neneve 235, 236 dhe 237 të ligjit nr. 115/2016, si edhe të pikave 29, 75 dhe 87 të Vendimit nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, duke vlerësuar paraprakisht se ka disa të dhëna dhe gjetje në lidhje me pasurinë që mund të sjellin ndalimin e kandidimit, anëtarja e Këshillit relatore e çështjes ka proceduar me përgatitjen e relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm dhe e ka dërguar çështjen për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit.

31. Në zbatim të pikës 33 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Kryetari ka thirrur mbledhjen e Këshillit duke njoftuar anëtarët për zhvillimin e saj në datën 24.07.2019, rendin e ditës, si edhe duke i bashkëlidhur njoftimit materialet e çështjes. Në rendin e ditës është përfshirë edhe çështja me objekt shqyrtimin e gjetjeve në procedurën e verifikimit të kandidimit të znj. Eris Hysi, për vendin vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, të shpallur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në datën 01.03.2019.

32. Në zbatim të pikës 34 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes, së bashku me relacionin e përgatitur nga relatori, i është njoftuar kandidatës Eris Hysi.

33. I njëjti njoftim, së bashku me dokumentacionin e përgatitur nga relatori mbi veprimet e kryera gjatë procedurës së verifikimit, si edhe materiale të çështjes, i janë dërguar edhe Avokatit të Popullit.

34. Për zhvillimin e mbledhjes së Këshillit në datën 24.07.2019, rendin e ditës dhe relacionin e përgatitur janë njoftuar edhe subjektet që sipas ligjit ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit.

35. Dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes, si edhe rendi i ditës janë njoftuar publikisht edhe në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e caktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

36. Në mbledhjen e Këshillit, pas relatimit të parashtruar nga anëtari relator dhe shpjegimeve mbi pyetjet sqaruese të drejtuara nga anëtarët e Këshillit, Këshilli dëgjoi mendimin e

Avokatit të Popullit lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidates Eris Hysi.

37. Në thelb, Avokati i Popullit, krahas qëndrimit të përgjithshëm se edhe për këtë rast nuk ka pasur nga KED në dispozicion dokumentacionin e plotë, parashtrori se nisur nga korrespondenca ndërmjet relatorit dhe kandidates do të ishte i nevojshëm caktimi i një ekspertit në të drejtën tatimore për shkak se çështja në diskutim ka të bëjë me një problem tatimo për të cilin nuk ka parashikim në ligj dhe nuk ka hetim të plotë në këtë drejtim për të ardhur në një konkluzion përfundimtar. Në reacion nuk ka shpjegim nëse DSIK ka dërguar informacion për plotësimin e kushtit të parashikuar nga shkronja "e" pika 1 e nenit 199 të ligjit nr. 115/2016 dhe për këtë nevojitej përgjigja e këtij insitucioni.

II. Vlerësimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi

38. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, duke u bazuar në dispozitat ligjore dhe ato nënligjore normative të zbatueshme për çështjen në shqyrtim, si edhe në rrethanat e faktit që rezultojnë në aktet që përmban dosja e kandidimit, vlerëson se duhet të procedojë me vendim për lejimin e kandidimit të kandidates Eris Hysi për vendin vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, të shpallur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në datën 01.03.2019.

39. Në pikën 3 të nenit 147/d të Kushtetutës, parashikohet se:

"3. Inspektori i Lartë i Drejtësisë zgjidhet me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit, për një periudhë 9-vjeçare, pa të drejtë rizgjedhjeje, nga radhët e juristëve të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë pune në profesion, me integritet të lartë moral dhe profesional. Ai nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit."

40. Në pikën 1 të nenit 199 të Ligjit nr. 115/2016 parashikohet se:

"1. Inspektor i Lartë i Drejtësisë mund të zgjidhet shtetasi shqiptar, që në momentin e kandidimit përmbush këto kushte:

a) të jetë shtetas shqiptar;

b) të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi me diplomë "Master i shkencave", ose diplomë të njësuar me të, ose studimet universitare për drejtësi jashtë shtetit dhe të ketë marrë një diplomë të njësuar, sipas rregullave për njësimin e diplomave, të parashikuara me ligj;

c) ka jo më pak se 15 vjet përvojë pune në profesion si jurist;

ç) nuk është dënuar më parë për kryerjen e një vepre penale;

d) nuk është pushuar nga puna më parë për shkaqe disiplinore dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi në momentin e kandidimit;

dh) nuk ka mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit;

e) nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar të ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991 në kuptimin e ligjit "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë".

ë) nuk është bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimeve të inteligjencës."

41. Kushtet e kandidimit për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, të parashikuara nga Kushtetuta dhe ligjet e nxjerra në pajtim me të, sikurse janë edhe ato të përmendura në pikat 39 dhe 40 më sipër, duhet të plotësohen secila dhe të gjitha së bashku në mënyrë që kandidati të

pranohet për tu vlerësuar dhe renditur sipas meritave nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi dhe më tej për tu zgjedhur Inspektor i Lartë i Drejtësisë nga Kuvendi.

42. Nëse kandidati për Inspektor i Lartë i Drejtësisë nuk plotëson qoftë edhe njërin prej kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit, kjo do të përbënte motiv ligjor të mjaftueshëm për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi për të vënë në bisedim dhe për të disponuar ndalimin e kandidimit, pa qenë më e nevojshme të arsyetojë për plotësimin ose jo të kushteve të tjera ligjore.

43. Nisur nga të dhënat dhe gjetjet që rezultojnë nga procedura e verifikimit për kandidaten Eris Hysi, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerësoi të bisedojë dhe të konkludojë pikësëpari në lidhje me plotësimin ose jo të kushtit ligjor të parashikuar nga neni 235 i ligjit nr. 115/2016, pra që kandidati të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij.

44. Për sa i përket procedurës së verifikimit të pasurisë, në përfundim të veprimeve të kontrollit të ushtruar në zbatim të nenit 235 të ligjit nr.115/2015, të ligjit nr. 9049/2003 dhe ligjit nr. 9367/2005, ILDKPKI, me shkresën nr. 2/28 prot., datë 30.05.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidaten Eris Hysi dhe personat e lidhur me të.

45. Në përfundim të analizës së hollësishme financiare të kryer mbi bazën e gjetjeve të siguruar nga informacionet e dërguara nga institucione publike dhe subjekte private, lidhur me deklarimin e pasurisë dhe interesave private të kandidates Eris Hysi, ILDKPKI në raportin e paraqitur ka ardhur në përfundimet se:

- a) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- b) ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor,
- c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- ç) nuk ka kryer deklarim të rremë;
- d) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

46. Përfundimet e sipërcituara të ILDKPKI, bazohen në gjetjet vijuese të raportit të kontrollit:

- Lidhur me blerjen e apartamentit me adresë “K.....D....” Tiranë, rezulton se nuk është ndjekur rruga ligjore për kalimin e pronësisë nga ana e palëve shitëse të palët blerëse, pasi regjistrimi i apartamentit në emër të Eris Hysit është bërë me çmimin 77.347 euro dhe jo me çmimin real të paguar nga ana e saj prej 108.000 Euro. Në kontratat e nënshkruara nuk evidentohen nëse janë paguar ose jo detyrimet tatimore lidhur me transaksionet e kryera.
- Deklarim i pasaktë lidhur me të ardhurat nga shpërndarja e fitimit pranë shoqërisë “H.....”, pasi subjekti ka deklaruar dhe dokumentuar nga kjo shoqëri fitimin pas tatimit në shumën totale 16.112.653 lekë për periudhën 2013 - 2018, ndërsa referuar Deklaratave Individuale Vjetore të të Ardhurave sipas DRT Tiranë, të ardhurat nga burime të tjera deklaruar nga kandidati Eris Hysi për të njëjtën periudhë janë në shumën 9.340.292 lekë. Mungon informacion nëse janë paguar detyrimet tatimore lidhur me këto të ardhura.
- Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor, lidhur me të ardhurat nga paga pranë “H.....” me nipt K..... për periudhën 2003-2008 dhe pranë “H.....” me

Nipt K..... nga Shkurt 2008 Mars 2019, deklaruar në shumën 14.596.849 lekë (konfirmuar pjesërisht nga ISSH).

- Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me të ardhurat si eksperte e Institutit S.N. në shumën 1.955 USD.

47. Në zbatim të pikës 26 të Vendimit nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, nisur nga gjetjet e sipërcituara në rezultatet e kontrollit të ushtruar dhe përfundimet e raportit të ILDKPKI, në datën 31.05.2019, Këshilli ka njoftuar në rrugë elektronike kandidaten Eris Hysi mbi të drejtën e saj për të dhënë shpjegimet përkatëse mbi këto gjetje, si edhe të depozitohë çdo dokument justifikues që vlerëson se e disponon.

48. Kandidatja Eris Hysi, në datën 05.06.2019, ka depozituar pranë Këshillit shpjegimet e saj me shkrim lidhur me gjetjet e njoftuara të procedurës së verifikimit për sa i përket kontrollit të pasurisë, nëpërmjet të cilave, në thelb, parashtron se:

- Konkluzioni përfundimtar i arritur nga Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, sipas aktit të aktit të kontrollit të paraqitur pas deklarimit nga ana ime sipas ligjit, është se unë e nënshkruara nuk gjendem në situatën e konfliktit të interesit, nuk kam kryer deklarim të rremë dhe nuk kam fshehur pasurinë. Ky është dhe qëllimi i kontrollit të figurës sipas ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive, të Detyrimeve Financiare të Zgjedhurve dhe të disa Nëpunësve Publikë”, i ndryshuar.
- Gjithsesi, në mënyrë kontradiktore, ILDKPKI në të njëjtin akt kontrolli ka konstatuar se deklarimi nuk është i saktë dhe ka mungesë dokumentacioni justifikues. Pavarësisht se sipas ligjit të posaçëm të sipërpërmendur, përkatësisht nenit 27 të tij, ILDKPKI minimalisht ka pasur detyrimin për të më thërritur dhe dëgjuar në lidhje me Deklarimin e kryer nëse ka pasur dyshime për të dhënat e deklarimit, kjo mundësi nuk më është dhënë. Për këtë arsye, në lidhje me çështjet problematike të ngritura në akt kontroll, gëzoj të drejtën e paraqitjes së qëndrimit tim, sipas argumenteve të mëposhtme dhe dokumentacionit përkatës që i bashkëlidhet kësaj parashtrëse.
- Në lidhje me pasaktësinë e gjetur nga ana e ILDKPKI për sa i përket transaksionit të shitblerjes së pasurisë së paluajtshme, referimi bëhet nëse është paguar apo jo një taksë për shitjen e pasurisë, detyrim ky i shitësit në një transaksion shit-blejshme pasurie. Në bazë të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar, në pozicionin e kandidates për pozicionin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kam detyrimin e deklarimit të të gjitha pasurive që zotëroj, detyrim të cilin e kam përmbushur, duke e shoqëruar këtë deklarim dhe me dokumentacionin përkatës justifikues. Sipas deklarimit është treguar mënyra si është kryer transaksioni i blejshme së pasurisë së paluajtshme në Ç....., pra në bazë të kontratave të rregullta noteriale si dhe është treguar mënyra e pagesës së çmimit përkatës. Detyrimi i taksës për shitjen, të cilit i referohet ILDKPKI, nuk është një detyrim që ligji fiskal ja ngarkon blerësit, referuar nenit 8, pika dh) të ligjit nr. 8438, datë 28/12/2008 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar, por është një taksë që paguhet nga personi që gjeneron të ardhura, pra në çdo rast Shitësi. Nëse transaksioni ka probleme në lidhje me taksën e shitjes, ky është një fakt që duhet të drejtohet shitësit apo institucionit që ka kryer regjistrimin e kontratës së shit-blejshme së pasurisë së paluajtshme. Nga ana e ime si deklaruuese janë përmbushur të gjitha detyrimet ligjore sipas asaj kontrate dhe kam fituar në mënyrë të ligjshme pronësinë mbi pronën. Sa më sipër, konkluzioni për pasaktësi i ILDKPKI është i pambështetur jo vetëm në ligjin e posaçëm 9049/2003, por dhe në legjislacionin shqiptar në përgjithësi, e atij fiskal në veçanti.

- Për sa i përket pronësisë së automjetit, deklarimi në formularin përkatës është bërë sipas kërkesave të ligjit dhe të udhëzimeve përkatëse. Gjithsesi bashkëlidhur ju lutem gjeni kopje të faturës së blerjes së automjetit dhe lejen e qarkullimit, duke qenë se dokumenti i pronësisë gjendet në dosjen e DPSHTRR, prej nga ka marrë konfirmim dhe vetë ILDKPKI.
- Në lidhje me depozitën e kursimit pranë BKT, dhe dy llogarive të kursimit pranë BKT deklarimi është bërë i saktë, sipas konfirmimit të vetë bankës dhe formulari është plotësuar sipas kërkesave të ligjit dhe udhëzimeve përkatëse të formularit. Dokumentacion ligjor mund të përbëhet vetëm nga vërtetime përmbledhëse të bankës, pasi nuk ka formë tjetër të vërtetimit të tyre. Bashkëlidhur ju lutem gjeni ekstrakte përmbledhëse të lëshuar nga banka.
- Ndërsa për sa i përket pasaktësisë së gjetur në lidhje me deklarimin e fitimit krahasuar me Deklaratën Individuale Vjetore të të Ardhurave, përsëri mungon referenca ligjore se ku dhe pse qëndron pasaktësia. Në cilësinë e individit që kam krijuar të ardhura nga paga dhe të ardhura të tjera të tatueshme të cilat kalojnë kufirin e përcaktuar nga neni 13 i ligjit nr. 8438, datë 28.12.2008 “Për të tatimin mbi të ardhura”, i ndryshuar kam kryer rregullisht deklarimin vjetor pranë organit tatimor. Ndërsa në cilësinë e ortakes së shoqërisë së thjeshtë kam pasur të drejtën e tërheqjes së fitimit pas pagimit nga shoqëria të tatimit përkatës. Të ardhura nga paga dhe burime të tjera të tatueshme, sipas kuptimit të nenit 8, 13 të ligjit dhe pikës 2.3 të Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar, nuk përfshijnë të ardhura nga fitimi i realizuar në ortakëri. Për këto të ardhura, individit që i ka realizuar qoftë në formën e fitimit si person fizik tregtar apo si anëtar i një shoqërie të thjeshtë, nuk ka detyrim të deklarojë në deklaratën individuale vjetore të të ardhurave personale. Kjo është dhe arsyeja përse organi tatimor në përgjigjen e kthyer ILDKPKI nuk ka referuar problematika apo pasaktësi në deklarime apo dhe problematika për mospagim tatimesh. Në kuptim të ligjit “Për Tatimin mbi të Ardhurat” ka disa kategori të të ardhurave dhe secili grupim ka formën e tij të deklarimit dhe të pagimit të detyrimit tatimor përkatës. Për organin tatimor, si Eris Hysi në cilësinë e individit si Shoqëria e Thjeshtë “H.....” në të cilën unë mbaj cilësinë e anëtares, nuk kanë detyrime të pashlyera dhe mos deklarime.
- Për sa i përket të ardhurave nga paga, formulari është plotësuar sipas përcaktimeve të ligjit dhe të udhëzimit përkatës të formularit. Ato janë vërtetuar në formën e vetë deklarimit, gjithsesi bashkëlidhur ju lutem gjeni vërtetimin e punëdhënësit. Konfirmimi nga ana e institutit të sigurimeve shoqërore, siç dhe evidentohet nga vetë ILDKPKI në aktin e kontrollit, është i vështirë për tu marrë dhe kërkon një afat të konsiderueshëm kohor si për individin dhe për institucionin. Kështu sipas një të kërkesë të bërë si individ, është mundësuar marrja e këtij vërtetimi por pasi ka kaluar afati i deklarimit. Ju lutem bashkëlidhur gjeni vërtetimin përkatës të lëshuar nga ISSH për periudhën 2004-2012 dhe mandatet e pagesave të kryera për vitin 2003.
- Për sa i përket të ardhurave nga Instituti i S.N. në formën e pagesës së shërbimit si eksperte, formulari është plotësuar sipas përcaktimeve të ligjit dhe të udhëzimit përkatës të formularit. Ato janë vërtetuar në formën e vetë deklarimit, gjithsesi bashkëlidhur ju lutem gjeni vërtetimin përkatës të Institutit S.N.
- Në përfundim, duke qenë se në bazë të ligjit nr. 9049/2003, përmbushen kërkesat kryesore për një deklaram të vërtetë dhe të plotë të pasurisë dhe në mungesë të konfliktit të interesit pasuror, konkluzion gjithashtu i arritur nga IPDKPKI, shpresoj të merrni në konsideratë sqarimet e mësipërme dhe të arrini në një konkluzion të drejtë dhe përfundimtar.

49. Në datën 03.07.2019, Këshilli i ka drejtuar në rrugë elektronike pyetje shtesë kandidates Eris Hysi për sa vijon:

Pasi u njohëm me kundërshimet tuaja per raportin e vlerësimit të ILDKPI dhe ballafaqimin e tyre me materialet e dërguara kërkojmë disa sqarime shtesë prej jush, brenda datës 05.07.2019, për sa më poshtë:

a-Në deklaratat tuaja pranë organit tatimor në vitet 2013 e 2014 përputhen të ardhurat e përfituara nga shpërndarja e fitimeve të shoqërisë me ato të reklamuar prej jush pranë këtyre organeve, ndërkohë që në vitet më pas 2015 e në vijim nuk përputhen deklaratimet tuaja në organet tatimore me të ardhurat që referoni të fituara nga shpërndarja e fitimeve të shoqërisë sipas viteve. Si e shpjegoni këtë ndryshim të deklarimeve që keni bërë ndër vite për të ardhurat nga fitimet e shoqërisë?

b-Në kolonat e deklaratës së të ardhurave personale vjetore parashikohet si rubrike të ardhurat nga dividendët. Nisur nga kjo rrethanë shpjegoni nëse kishit apo jo detyrimin të bënin deklarinin e të ardhurave të përfituara nga veprimtaria e biznesit në ortakëri apo jo dhe pse?

c-Sipas vërtetimit të shoqërisë së thjeshtë ku ju jeni ortakë rezulton se ju keni fituar të ardhura në vite nga shpërndarja e fitimit. Shpjegoni se si dhe kur i keni përfituar këto të ardhura për secilin vit ? (pyetja ka të bëjë me faktin se ju duhet të sqaroni se si ju është bërë pagesa, pra me bankë apo dorazi, në cilën bankë, me mandat pagese ose vendim ë shpërdarjes së fitimit nga shoqëria etj.) Aktet konfirmuese duhet ti paraqisni së bashku me përgjigjen tuaj sqaruese.

d-Sipas lëvizjeve tuaja të llogarisë së vitit 2018 të BKT ju rezulton se keni përfituar transfertë nga shoqëria "H....." në shumat respektive;

-në datën 24.03.2018 shuma prej 10.000 euro.

-në datën 28.03.2018 shuma prej 15.000 euro

-në datën 10.09.2018 shuma prej 20.000 euro.

Ndërkohë nuk rezulton që ju të keni deklaruar specifikisht të ardhura për vitin 2018 në vlera të tilla pranë ILDKPI ose në dokumentacionin shoqërues. Jepni shpjegime lidhur me konstatimin e mësipërm.

e-Në vitin 2016 keni bërë përfitimin e të drejtave nga shtetasi F.P. për apartamentin në komunën F....., duke depozituar në llogari të noterit shumën prej 60.000 euro e cila më pas i ka kaluar shitësit të të drejtave. Ju lutem sqaroni burimin e krijimit të kësaj të ardhure dhe si e ku e keni ruajtur deri në momentin kur është bërë pagesa?

50. Kandidatja Eris Hysi, në datën 05.07.2019, me nr. 420 prot, ka depozituar pranë Këshillit shpjegimet e saj me shkrim lidhur me pyetjet e sipërcituara, nëpërmjet të cilave, në thelb, parashtron se:

1. Për herë të parë kam depozituar deklaratën e të ardhurave individuale sipas kërkesave të ligjit në vitin 2011. Më pas në vitin 2013, duke fituar cilësinë e ortakës së shoqërisë, janë krijuar të ardhura nga fitimi në shoqërinë e thjeshtë. Këto të ardhura gabimisht janë deklaruar në rubrikën të ardhura nga dividendi, pasi dhe nga ana e organit tatimor nuk ishte sqaruar ende se çfarë të ardhurash janë subjekt i deklaratës individuale vjetore të të ardhurave. Në Maj të vitit 2014, nga ana e organit tatimor është sqaruar kjo çështje me ndryshimet e pasqyruara në Udhëzimin nr. 5, datë 30.01.2006 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar. Sipas ndryshimeve përkatëse është theksuar që të ardhurat e tatueshme për qëllime të deklarinimit individual vjetor të të ardhurave (DIVA), nuk përfshijnë fitimin neto (pas pagimit të tatimit mbi fitimin apo tatimit të thjeshtuar mbi fitimin mbi biznesin e vogël) i personave fizikë tregtarë, pavarësisht nëse këta të fundit janë subjekt i tatimit mbi fitimin apo tatimit të thjeshtuar mbi fitimin mbi biznesin e vogël - këtu sqarojmë se pozicioni i personit fizik tregtar dhe anëtarit të shoqërisë së thjeshtë është i njëjtë. Në këto kushte, fitimi i realizuar në

shoqërinë e thjeshtë, nuk duhet të përfshihet në të ardhurat e realizuara për qëllim të deklarimit DIVA dhe për këtë arsye, në vitet në vijim nuk është përfshirë në deklaratë.

2. Duke referuar sa më sipër, shoqëria e thjeshtë në të cilën unë jam ortakë, nuk shpërndan dividend, pasi nuk është një nga format e personave juridik të rregulluara nga ligji që janë subjekt i tatimit mbi dividendin, në rast se do të shpërndahet një i tillë. Shoqëria e thjeshtë është bashkim personash fizik, në rastin konkret bashkim i licencave të tre avokatëve dhe në bazë të ligjit trajtimi është i njëjtë me personin fizik, i cili merr fitim pas pagimit të tatimit përkatës në mbyllje të vitit financiar. Fitimi i marrë në këtë formë përjashtohet nga ndonjë takse apo tatim tjetër dhe shpërndahet mes personave fizik. Në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të ardhura” i ndryshuar, në nenin 2 të tij, gërma g) pika iv, është dhënë përkufizimi i ortakërisë, dhe më tej ligji përcakton qartë që ky lloj organizimi është vetëm subjekt i tatimit mbi fitimin dhe nuk ndan dividend të tatuashëm por vetëm fitim. Për këto arsye, dhe sipas përcaktimeve të ligjit dhe udhëzimit përkatës të përmendur më sipër në pikën 1, nuk kam detyrim të bëj deklaram për të ardhurat nga fitimet si rezultat i pjesëmarrjes si ortakë në shoqërinë e thjeshtë.

3. Shpërndarja e fitimit të shoqërisë së thjeshtë ndër vite është bërë nëpërmjet transferimit në llogarinë bankare si dhe pagesa cash nga arka e shoqërisë. Fitimet e realizuara ndër vite nga përqindja e pjesëmarrjes janë si vijon:

Viti	Fitimi Tregtar	T.Fitimi	Fitimi neto	% e pjesëmarrjes	
2013	5%	1,032,385
2014	5%	1,637,849
2015	10%	3,218,168
2016	10%	5,604,043
2017	10%	4,465,302
2018	10%	154,906
TOTALI					16,112,653

Këto fitime janë tërhequr nga shoqëria pjesërisht në vitin korrent dhe pjesërisht në vitet pasardhëse. Përmbledhja e këtyre fitimeve të tërhequra ndër vite është si vijon:

Viti	Arka	Banka	Totali	Pagese Fitimi
2014	Viti 2013 Pjesërisht 2014
2015	Viti 2014 Pjesërisht 2015
2016	Viti 2015 Pjesërisht 2016
2017	Pjesërisht 2016
2018	Viti 2016 Pjesërisht 2017
2019	Viti 2017 Pjesërisht 2018
Totali	5,072,015	11,040,638	16,112,653	--

Bashkëlidhur ndodhet detajimi i të ardhurave për çdo vit së bashku me dokumentet justifikues të pagesave, mandatat e arkës dhe gjendje e llogarisë bankare (shënuar me ngjyrë të verdhë). Çdo vit është paraqitur si aneks më vete.

4. Referuar sa me sipër, transfertat e vitit 2018, i përkasin pagesave të fitimeve të viteve të mëparshëm, pra nuk i përkasin fitimit të vitit 2018. Deklarimi i bërë pranë ILDKPI përmban të gjitha tërheqjet e kryera të fitimeve të prapambetura dhe janë pasqyruar përkatësisht në rubrikën Angazhime dhe Veprimtari Private dhe/ose Publike dhe të Ardhurat e Krijuara prej Tyre, faqja 5 e deklaratës, pika e parë, me përmbajtje si vijon:

Përshkrimi i të ardhurave	Shuma e të ardhurave neto të krijuara, në lekë apo në valutë (me shifra dhe me fjalë)
Të ardhura nga fitimi si pjesmarrje në aktivitetin e “H.....” me Nipt K..... periudhën 2013-2018	16 112 653 (gjashtëmbëdhjetë milion e njëqind e dymbëdhjetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tre) lekë

5. Përsa i përket burimit prej të cilave janë krijuar të ardhurat për blerjen e një apartamenti në komunën F....., sqaroj se burimi përbëhet nga të ardhurat nga fitimi në shoqëri dhe nga kursimet nga paga ndër vite. Nga vlera 60.000 euro, në total nga llogaritë bankare janë paguar 43.700 euro, ndërsa 16.300 euro janë paguar cash, nga fitimet e tërhequra në këtë formë përgjatë vitit 2015 dhe 2016, siç është shpjeguar dhe më sipër. Provat në lidhje me burimin e krijimit të këtyre të ardhurave përbëhen nga ekstraktet bankare që vërtetojnë derdhjen e shumave përkatëse si fitim, ekstraktet e bankave në lidhje me kursimet e krijuara nga paga dhe mandatet e pagesës nga arka e shoqërisë për tërheqjen e fitimit gjatë viteve 2015 dhe 2016, mandate që i gjeni bashkëlidhur në provat për tërheqjen e fitimit sipas viteve përkatëse.

51. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në kuadër të procesit të verifikimit të kushteve të kandidimit për Inspektor të Lartë të Drejtësisë, i ka kërkuar Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë të dhëna dhe sqarime për sa më poshtë:

1. Shoqëria e thjeshtë “H.....”, e regjistruar me numër nipt K....., a ka deklaruar pranë organeve tatimore shpërndarje të fitimit të realizuar prej saj në periudhën nga vitit 2013-2018 në favor të anëtarëve (ortakëve të saj)? Nëse po ju lutem specifikoni shumën, kohën kur është vendosur shpërndarja e fitimit, aktin me të cilin është bërë shpërndarja e fitimit, si dhe ortakun konkret, që ka përfituar nga kjo shpërndarje.
2. Në bazë të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” të ndryshuar dhe udhëzimin nr.5 datë 20.01.2006 të ndryshuar ju lutem sqaroni nëse ortakët ose anëtarët e një subjekti tregtar të regjistruar në OKB si shoqëri e thjeshtë a duhet të deklaronin të ardhurat e përfituara nga shpërndarja e fitimit të shoqërisë në Deklaratën Individuale të të ardhurave për periudhën 2013-2018, sigurisht kur të ardhurat vjetore të tyre kalojnë vlerën mbi 2 000 000 lekë ? Në rast se po në cilën rubrikë të deklaratës i deklarojnë të ardhurat e përfituara nga shpërndarja e fitimit? Në rast se duhet t'i deklaronin këto të ardhura, a i nënshtrohen këto të ardhura tatimit mbi të ardhurat personale?

52. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me shkresën nr. 14775/3 prot, datë 01.08.2019 ka sqaruar si vijon:

1. Në lidhje me pyetjen për deklarimin e dividendit

Në Ligjin Nr. 8438, Datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, neni 33/1, paragrafi 1, janë përcaktuar kategoritë e subjekteve për të cilët kërkohet depozitimi i vendimit për miratimin e rezultatit vjetor dhe destinimi i fitimit.

“1. Shoqëritë tregtare, sipas ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, pas pagimit të tatimit mbi fitimin, sipas dispozitave të kreut III të këtij ligji, brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar, duhet të miratojnë në asamblenë e ortakëve apo organin kompetent vendimmarrës të shoqërisë rezultatet financiare të vitit paraardhës dhe ta destinonjë fitimin pas tatimit, duke përcaktuar shumën e rezervave ligjore, pjesën që do të përdoret për investime ose për shtesë kapitali dhe pjesën që do të shpëmdahet në formë dividendi”.

2. Në lidhje me pyetjen për deklarimin e të ardhurave nga individët

Në Ligjin Nr. 8438, Datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, neni 13/2 përcakton llojet e të ardhurave bruto të cilat duhet të përfshihen në deklaratën vjetore të të ardhurave. Pikat a) dhe pika b) të paragrafit 1 përfshijnë:

a) Të ardhura bruto nga paga apo shpërblimet nga marrëdhëniet e punësimit për individët.

Shënim: Deri në vitin 2014, kërkohej që të deklaroheshin edhe “fitimi nga zhvillimi i veprimtarisë së biznesit të vogël, që rezulton nga Deklarata e të Ardhurave Personale të Biznesit të Vogël për të vetëpunësuarit”. (Ky paragraf u shfuqizua me Ligjin nr. 156/2014, datë 27.11.2014. Botuar ne FL.Z. nr. 195, datë 24 dhjetor 2014).

b) të ardhurat bruto nga dividendi për pjesëmarrje në shoqëri tregtare apo nga veprimtaritë e biznesit.

3. Në lidhje me trajtimin e Fitimit mbas tatimit të shoqërive të thjeshta

3.1 Legjislacioni tatimor

a. Sipas nenit 33/1 të ligjit, shoqëritë tregtare të krijuara sipas ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare janë subjekt i detyrimit për deklarim të dividendit dhe mbajtjen në burim të tatimit në momentin e pagesës. Ndërsa neni 33, “Mbajtja në burim e tatimit mbi të ardhurat” në paragrafin 1 të nenit 13/2 kërkon që subjekti i cili është i detyruar të mbajë tatimin në burim, e mban këtë tatim për:

i. Dividentet

ii. Ndarjet e fitimit

b. Detyrimi i ortakëve për përfshirja në DIVA të fitimit të mbetur pas tatimit në shoqërinë e thjeshtë, nuk është përmendur në mënyrë eksplicite në nenin 13/2 të ligjit.

i. Nëse personat që kanë formuar shoqërinë e thjeshtë janë individë, pjesa e fitimit që ata marrin pas taksimit të shoqërisë së thjeshtë, nuk është e listuar në mënyrë eksplicite në paragrafin 1 të nenit 13/2. Por paragrafi g) i kësaj pike të nenit 13/2 kërkon që të përfshihen në deklaratën e të ardhurave edhe “të ardhurat e tjera bruto”, të papërmendura në pikën 1 të nenit.

ii. Nëse personat që kanë formuar shoqërinë e thjeshtë janë bashkim personash fizikë tregtarë, sikurse sqaruam, deri në fund të vitit 2014. deklarata kerkonte që të përfshiheshin edhe fitimet nga zhvillimi i veprimtarisë së biznesit të vogël.

3.2 Kodi Civil

Sipas nenit 1074 të Kodit Civil, parashikohet se “shoqëria është një kontratë me të cilën dy apo më shumë persona merren vesh për të ushtruar një aktivitet ekonomik me qëllim që të ndajnë fitimet që rrjedhin prej tij”. Ndërkohë, sipas nenit 1085 “çdo anëtar ka të drejtë të marrë pjesën e vet të fitimeve pas miratimit të raportit”.

3.3 Legjislacioni për regjistrimin e biznesit.

Në ligjin Nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Regjistrimin e Bisnesit” i ndryshuar, në nenin 22 “Detyrimi për regjistrim” paragrafi 1) pika “b” kërkon që të regjistrohen si entitet juridik edhe shoqëritë e thjeshta, sipas dispozitave të K.udit Civil. Pra ky ligj e trajton shoqërinë e thjeshtë si entitet juridik, të ndarë nga ortakët individë/persona fizikë tregtarë, që e krijojnë shoqërinë e thjeshtë. Bazuar në sa më sipër, shoqëria e thjeshtë realizon fitim i cili taksohet si fitim i një entiteti juridik sipas dispozitave të Ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”, ndërkohë që fitimi mbas tatimit disponohet nga individët/personat fizikë tregtarë që kanë themeluar shoqërinë e thjeshtë, i cili në dispozitat e legjislacionit tatimor trajtohet sa sqaruar më sipër.

53. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi verifikoi përputhshmërinë e të dhënave të deklaruara nga kandidatja Eris Hysi në *Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Privatë të Kandidatit për Pozicione të Ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë* që ka depozituar pranë ILDKPKI, mbi bazën e të cilave ky institucion ka realizuar analizën financiare dhe ka ardhur në përfundimet e tij, në raport me të dhënat që rezultojnë nga informacionet e dërguara pranë Këshillit nga institucionet publike dhe private të treguara në pikën 15 të këtij Vendimi.

54. Mbi bazën e verifikimeve të kryera, Këshilli i rezulton se nga ILDKPKI është konstatuar deklarim i pasaktë lidhur me të ardhurat nga shpërndarja e fitimit pranë shoqërisë “H.....”, pasi subjekti ka deklaruar dhe dokumentuar nga kjo shoqëri fitimin pas tatimit në shumën totale prej 16 112 653 lekë për periudhën 2013-2018, ndërsa referuar deklaratave individuale vjetore të të ardhurave sipas DRT Tiranë, të ardhurat nga burime të tjera të deklaruara nga kandidati Eris Hysi, për të njëjtën periudhë, janë në shumën 9.340.292 lekë. Mungon informacioni nëse janë paguar detyrimet tatimore për këto të ardhura.

55. Lidhur me këtë gjetje të ILDKPKI kandidatja Eris Hysi ka kundërshtuar se ajo nuk ka detyrim të deklarojë të ardhurat e fituara nga shpërndarja e fitimit të shoqërisë së thjeshtë në deklaratën vjetore të të ardhurave pranë organit tatimor, pasi sipas saj pozicioni i personit fizik tregtar dhe i anëtarit të shoqërisë së thjeshtë është i njëjtë. Nisur nga ky qëndrim, kandidatja ka theksuar se sipas pikës 2.3.3 të udhëzimit nr.5 datë 30.01.2006 të Ministrisë të Financave, fitimi i realizuar në shoqërinë e thjeshtë nuk duhet të përfshihet në të ardhurat e realizuara për qëllime të deklarimit DIV dhe për këtë arsye nuk është përfshirë në deklaratë.

56. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi konstaton se deklarimi i të ardhurave të tjera pranë tatimeve në deklaratën vjetore të të ardhurave përkonin me të ardhurat e deklaruara nga shpërndarja e fitimit në shoqërinë “H.....” për vitet 2013 e 2014 dhe më pas ndryshonin. Për këtë ju kërkuar sqarime kandidates Eris Hysi se përse kishte ndodhur ky ndryshim i deklarimeve të saj për të ardhurat në vite pranë drejtorisë së tatimeve. Lidhur me këtë konstatim kandidatja është përgjigjur se këto të ardhura gabimisht janë deklaruar në rubrikën të ardhurat nga dividendi pasi nga organi tatimor nuk ishin sqaruar se çfarë të ardhurash janë subjekt i deklaratës individuale vjetore të të ardhurave. Në Maj të vitit 2014 nga organi tatimor është sqaruar kjo çështje me ndryshimet e pasqyruara në udhëzimin nr.5 datë 30.01.2006 të ndryshuar 2006 të Ministrisë të Financave, nuk përfshijnë fitimin neto të personave fizik tregtar pavarësisht nëse janë subjekt i tatimit mbi fitimin ose tatimit të thjeshtuar. Pozicioni i personit fizik tregtar është i njëjtë me atë të anëtarit të shoqërisë së thjeshtë.

57. Gjithashtu në vijim të sqarimeve të dhëna në datën 05.07.2019, kandidatja Eris Hysi ka shtuar se shoqëria e thjeshtë është bashkimi i licencave të tre ortakëve dhe në bazë të ligjit trajtimi është i njëjtë me personin fizik që merr fitimin pas pagimit të tatimit përkatës në mbyllje të vitit financiar, fitimi i marrë në këtë formë përjashtohet nga ndonjë taksë apo tatim tjetër dhe i shpërndahet personit fizik. Në ligjin nr.8438 datë 24.12.1998 neni 2, shkronja “g”,

pika iv, është dhënë përkufizimi i ortakërisë dhe ky organizëm është vetëm subjekt i tatimit mbi fitimin dhe nuk ndan dividend të tatueshëm por vetëm fitim. Në përmbledhje kandidatja pretendon se nuk ka detyrim të bëjë deklarime në tatime për të ardhurat nga fitimet si rezultat i pjesëmarrjes si ortakë në shoqërinë e thjeshtë, sikurse është organizuar shoqëria “H.....”, ku ajo aktualisht bën pjesë si ortakë me 15 %.

58. Pas analizës së gjetjeve të ILDKPKI, shpjegimeve të kandidatës dhe konsultimit me kuadrin ligjor e nënligjor për statusin e personave që ushtrojnë aktivitet tregtar në formën e shoqërisë së thjeshtë, KED vlerëson bindëse prapësimet e kandidatës Eris Hysi, për sa i përket faktit që legjislacioni tatimor nuk detyron në mënyrë eksplicite palët kontraktore (anëtarët) që kanë themeluar një shoqëri të thjeshtë që të përpilojnë deklaratën vjetore të të ardhurave, duke i barazuar kështu me statusin e personit fizik tregtar në kuptim të pikës 2.3.3 të Udhëzimit Nr. 5, datë 30.05.2006 i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 14 të vitit 2014. Pra sipas këtij parashikimi ligjor bëhet e qartë pikëpyetja e ngritur nga ILDKPKI në konkluzionet e veta, pasi kandidatja Eris Hysi, si ortakë e një shoqërie të thjeshtë, gëzon statusin e personit fizik dhe nuk ka detyrimin që të deklarojë të ardhurat e përfituara si ortakë nga shpërndarja e fitimit në shoqërinë e thjeshtë.

59. Në nenin 2.3.3 të udhëzimit nr.5, datë 30.05.2006 përcaktohet se:

“2.3.3 Të ardhurat që rrjedhin nga fitimi i ortakut apo i aksionerit në shoqërinë tregtare (pika b) e paragrafit 1. Në kuptim të kësaj pike, bëhet fjalë për të ardhurat që përfitojnë individët, në formën e ndarjes së fitimit nga ortakëritë, apo të dividendit nga shoqëritë tregtare. Në të ardhurat e tatueshme sipas kësaj pike nuk përfshihet fitimi neto (pas pagimit të tatimit mbi fitimin apo tatimit të thjeshtuar mbi fitimin mbi biznesin e vogël) i personave fizikë tregtarë, pavarësisht nëse këta të fundit janë subjekt i tatimit mbi fitimin apo tatimit të thjeshtuar mbi fitimin mbi biznesin e vogël. (Ndryshuar me Udhëzim Nr.14, datë 23.05.2014. Botuar në FI.Z Nr. 80, datë 4 qershor 2014).”

60. Kandidatja Eris Hysi ka sqaruar se në vitin 2014 është njohur me lehtësirat specifike që ligji parashikonte për personat fizike duke i përfshirë ata nga detyrimi për të plotësuar deklaratën e të ardhurave vjetore (DIVA) dhe për këtë arsye ka ndryshuar qëndrimin lidhur me deklarimin e të ardhurave të fituara nga shpërndarja e fitimit të shoqërisë së thjeshtë në deklaratën vjetore të të ardhurave pas viteve 2013-2014. Ky pretendim gjen mbështetje edhe në provat e paraqitura nga kjo kandidatë dhe konkretisht, sqarimit të dhënë në muajin Maj të vitit 2014 nga organi tatimor.

61. Për sa i përket diskutimit nëse duhet apo jo kandidatja të deklaronte të gjitha të ardhurat e fituara prej saj nga shpërndarja e fitimeve si palë në kontratën e shoqërisë së thjeshtë, KED vlerëson të evidentojë ligjin e zbatueshëm në këtë rast të ushtrimit të veprimtarive të tatueshme.

62. Kështu, në nenin 1074 të Kodit Civil parashikohet se:

“Shoqëria është një kontratë me të cilën dy apo më shumë persona merren vesh për të ushtruar një aktivitet ekonomik, me qëllim që të ndajnë fitimet që rrjedhin prej tij. Personi anëtar i shoqërisë duhet të vërë në dispozicion të këtij aktiviteti para, sende apo shërbime”.

63. Ndërsa në nenin 1075 të këtij Kodi parashikohet se:

“Në shoqërinë e thjeshtë kontrata nuk është objekt i ndonjë forme të veçantë, përveç kur kërkohet nga natyra e sendeve të bashkuara.

Shoqëria është e thjeshtë, kur nuk paraqet cilësitë dalluese të shoqërisë tregtare të rregulluara në Kodin Tregtar”.

64. Marrëdhënie me të tretët parashikohen në nenin 1088 të K.Civil:

“Në mungesë të dispozitave të tjera në kontratë, përfaqësimi i takon çdo anëtar administrator dhe shtrihet për të gjitha aktet që përfshihen në objektin e shoqërisë. Ndryshimet dhe shuarja e tagrave të përfaqësimit rregullohen me dispozitat për përfaqësimin.

Shoqëria fiton të drejta dhe merr përsipër detyrime me anë të anëtarëve që kanë të drejtën për ta përfaqësuar.”.

65. Në Ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të regjistrimit” parashikohen se cilat janë subjektet që kanë detyrimin për regjistrim në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Në nenin 22 dhe 53 të këtij ligji parashikohet se:

“Neni 22 Detyrimi për regjistrim

-Subjektet që detyrohen të regjistrohen në regjistrin tregtar janë:

- a) personat fizikë, që ushtrojnë veprimtari ekonomike tregtare;
 - b) shoqëritë e thjeshta sipas dispozitave të Kodit Civil;**
 - c) shoqëritë tregtare;
 - ç) degët dhe zyrat e përfaqësimit të shoqërive të huaja;
 - d) shoqëritë dhe unionet e kursim-kreditit;
 - dh) shoqëritë e bashkëpunimit të ndërsjellë;
 - e) çdo subjekt tjetër, për të cilin parashikohet detyrimi për regjistrim, në bazë të legjislacionit shqiptar.
2. Subjektet, përveç kur parashikohet ndryshe nga ligje të posaçme, aplikojnë për regjistrim fillestar brenda një afati 15-ditor, i cili llogaritet:
- a) për personat fizikë, shoqëritë e thjeshta dhe degët apo zyrat e përfaqësimit të shoqërive të huaja nga data e nisjes së veprimtarisë;
 - b) për personat juridikë nga data e themelimit.
3. Për regjistrimet e tjera të detyrueshme, aplikimi bëhet brenda 30 ditëve nga data e ngjarjes së rrethanës faktike dhe/ose e formimit të aktit të detyrueshëm për t'u regjistruar.

Neni 53 Pasojat e çregjistrimit

Çregjistrimi i personave juridikë nga regjistri tregtar ka si pasojë humbjen e personalitetit juridik të subjekteve, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga ligje të posaçme.

Çregjistrimi nga regjistri tregtar i personave fizikë, degëve dhe zyrave të përfaqësimit të shoqërive të huaja, shoqërive të thjeshta, sipas Kodit Civil, si dhe të subjekteve të tjera që, sipas legjislacionit në fuqi, nuk fitojnë personalitetin juridik nëpërmjet regjistrimit, ka vetëm efekt deklarativ.

Subjektet e çregjistruara përgjigjen për detyrimet e mbetura ndaj të tretëve dhe ndaj autoriteteve publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi.”

66. Nisur nga këto parashikime ligjore, anëtarët e shoqërisë së thjeshtë mund të barazohen për nga cilësia me subjektin “tregtari si person fizik” i parashikuar në ligjin nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, në të cilin, në nenin 2, pikat 1 dhe 2 parashikohet se:

“ 1. Tregtari është personi fizik, sipas kuptimit të Kodit Civil, i cili ushtron veprimtari ekonomike të pavarur, që kërkon një organizim tregtar të zakonshëm.

2. Personi fizik, i cili ushtron një profesion të pavarur (si avokat, noter, kontabilist, mjek, inxhinier, arkitekt, artist etj.), vlerësohet tregtar, nëse një ligj i posaçëm i ngarkon këtë status.”

67. Në nenin 2.3.3 të Udhëzimit nr.5 datë 30.05.2006 të Ministrisë të Financave parashikohet se:

“2.3.3 Të ardhurat që rrjedhin nga fitimi i ortakut apo i aksionerit në shoqërinë tregtare (pika b) e paragrafit 1.

Në kuptim të kësaj pike, bëhet fjalë për të ardhurat që përfitojnë individët, në formën e ndarjes së fitimit nga ortakëritë, apo të dividendit nga shoqëritë tregtare. Në të ardhurat e tatueshme sipas kësaj pike nuk përfshihet fitimi neto (pas pagimit të tatimit mbi fitimin apo tatimit të thjeshtuar mbi fitimin mbi biznesin e vogël) i personave fizikë tregtarë, pavarësisht nëse këta të fundit janë subjekt i tatimit mbi fitimin apo tatimit të thjeshtuar mbi fitimin mbi biznesin e vogël. (Ndryshuar me Udhëzim Nr.14, datë 23.05.2014. Botuar në FI .Z Nr. 80, datë 4 qershor 2014).”

68. Nisur nga interpretimi i këtyre dispozitave, rezulton e qartë se, shoqëria e thjeshtë ,duke mos pasur personalitet juridik, nuk mund të konsiderohet si subjekt më vehte i së drejtës as në aspektin fiskal. Siç përcaktohet në dispozitat përkatëse të Kodit Civil, janë anëtarët e saj që kanë lidhur kontratën e shoqërisë së thjeshtë të cilët mbartin të gjitha të drejtat dhe detyrimet, duke e caktuar njërin prej tyre si përfaqësues ose duke qenë njëkohësisht secili prej tyre përfaqësues i saj.

69. Në nenin 2 të ligjit nr. 8438/1998 parashikohet se për qëllimet e këtij ligji emërimi “tatimpagues” nënkupton :

“iv) një “ortakëri”, si bashkim personash, fizikë dhe juridikë, për të kryer një veprimtari përkohshme, të përbashkët me qëllim fitimi, që nuk krijohet si person juridik me vete në format e parashikuara nga ligji “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, nga Kodi Civil ose nga ligje të veçanta”.

70. Prandaj edhe KED mban parasysh që dispozitat që rregullojnë shoqërinë e thjeshtë nuk e lidhin këtë bashkim me ndonjë afat të veçantë apo për një veprimtari të përkohëshme siç shprehet përkufizimi i mësipërm i ligjit për tatimit mbi të ardhurat. Të tilla bashkime të subjekteve tregtare mund të konsiderohen bashkimet e operatorëve të ndryshëm ekonomike për veprimtari të caktuara tregtare, e cila kryesisht aplikohet nga shoqëritë tregtare me qëllim plotësimin e kushteve dhe kriterëve të ndryshme në procedura të caktuara prokurimi.

71. Për të përcaktuar nëse anëtari i shoqërisë së thjeshtë, siç është në rastin konkret kandidatja Eris Hysi, përfshihet apo jo në konceptin e termi “ortakëri” të përdorur në këtë përkufizim të ligjit, duhet të kemi parasysh faktin që shoqëria e thjeshtë sipas përkufizimeve të bërë në nenin 1074 e vijues të Kodit Civil, është një nga shumë kontratat që njeh pjesa e detyrimeve të këtij Kodi dhe palët në këtë kontratë i kategorizon si “anëtarë” të shoqërisë dhe jo si ortakë.

72. Po kështu, në lidhje me pozitën e anëtarit të shoqërisë së thjeshtë duhet të kemi parasysh që shoqëria e thjeshtë nuk fiton asnjëherë personalitet juridik, pavarësisht faktit që regjistrohet në QKB, sipas ligjit të sipërcituar për QKR-në. Njëkohësisht, mbahet parasysh që anëtarët e shoqërisë së thjeshtë duhet të gëzojnë cilësitë e personit fizik tregtar me qëllim që të kenë aftësinë dhe potencialin e ushtrimit të një profesioni të lirë, zanati apo veprimtarie tjetër me qëllim fitimin, si dhe faktin që këta persona mbajnë përgjegjësi të pakufizuar për

humbjet që u shkaktohen të tretëve. Në kushtet kur bashkimi i personave në kontratën e shoqërisë së thjeshtë nuk krijon një subjekt të së drejtës, është e qartë që statusi i secilit anëtar të kësaj shoqërie të thjeshtë barazohet me statusin e personit fizik tregtar i cituar në nenin 2.3.3 të udhëzimit nr.5 datë 30.05.2006 i Ministrisë të Financave.

73. Këshilli vëren se, në rastin në shqyrtim, fakti që shoqëria e thjeshtë “Hl.....” është regjistruar në QKR nuk do të thotë që kjo anëtarësi e shoqërisë së thjeshtë i nënshtrohet rregullave të shoqërive tregtare të cilat janë të parashikuara në ligjin Nr.9901/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” sepse shoqëria e thjeshtë nuk ka personalitet juridik me vehte dhe nuk gëzon cilësinë e subjektit të së drejtës. Fakti i bashkimit të personave (anëtarëve), persona fizikë tregtarë, në një kontratë të shoqërisë së thjeshtë i ka krijuar atyre lehtësira dhe detyrime për tu identifikuar nga ky bashkim vetëm për efekt të pagimit të tatimit të fitimit, në rastin konkret, tatimit mbi fitimin vjetor të realizuar nga të gjithë anëtarët e shoqërisë së thjeshtë. Por KED nuk ndalon në analizën e këtij tatimi pasi nuk rezulton si gjetje e ILDKPKI-së.

74. Sipas kësaj analize, Këshilli vlerëson se togfjalëshi “ndarja e fitimit nga ortakëritë”, i cituar në fjalinë e parë të nenit 2.3.3 të Udhëzimit Nr.5 datë 30.05.2016 të Ministrisë të Financave, nuk mund të konsiderohet se përfshin dhe ortakët e shoqërisë së thjeshtë. Në kushtet kur ky togfjalësh i referohet fjalisë së parë ky është shpjegim se çfarë duhet të kuptojmë me “ *Të ardhurat që rrjedhin nga fitimi i ortakut apo i aksionerit në shoqërinë tregtare (pika b) e paragrafit* “. Pra, i referohet ortakërisë së një shoqërie tregtare e cila mund të jetë me ortakë ose me aksionerë, në varësi të tipit të shoqërisë tregtare, por jo personave fizike që kanë lidhur kontratën e shoqërisë së thjeshtë e cila, në asnjë rast, nuk konsiderohet si shoqëri tregtare. Po kështu, në asnjë rast nuk mund të konsiderohet se kontrata e shoqërisë së thjeshtë të ketë personalitet juridik me vehte apo të mund të konsiderohet si subjekt i të drejtës.

75. Udhëzimi nr.5 datë 30.01.2006, i ndryshuar, i Ministrisë të Financave, parashikon se tatimi mbi të ardhurat personale, përfshin të gjitha llojet e të ardhurave të individëve, të parashikuara nga Ligji. Në kuptim të nenit 8 të ligjit nr.8438/1998, të ardhura të tatueshme për qëllim të tatimit mbi të ardhurat personale përfshihen edhe të ardhurat që përfitojnë individët, në formën e ndarjes së fitimit nga ortakëritë apo të dividendit nga shoqëritë tregtare. Në të ardhurat e tatueshme sipas kësaj pike nuk përfshihet fitimi neto (pas pagimit të tatimit mbi fitimin apo tatimit të thjeshtuar mbi fitimin mbi biznesin e vogël) i personave fizikë tregtarë, pavarësisht nëse këta të fundit janë subjekt i tatimit mbi fitimin apo tatimit të thjeshtuar mbi fitimin mbi biznesin e vogël. Të ardhurat e personit fizik tregtar nga ushtrimi i aktivitetit tregtar taten vetëm sipas kreut III “Tatimi mbi fitimin” (nenet 16-32 të ligjit) në rastin e subjekteve me xhiro mbi 8 milionë lekë në vit dhe sipas ligjit nr. 9632/2006 për subjektet me xhiro deri në 8 milionë lekë në vit. Personi fizik tregtar nuk ka personalitet juridik të ndryshëm nga individi (i regjistruar si tregtar), ndryshe nga rasti i shoqërive tregtare dhe ortakëve të saj individë dhe, rrjedhimisht, fitimi neto i personit fizik tregtar nuk konsiderohet si e ardhur personale e individit, subjekt i shkronjës “g” të nenit 8 të ligjit.

76. Duke iu referuar interpretimit dhe zbatimit të këtij kuadri ligjor, KED vlerëson se të ardhurat e përfituara nga ndarja e fitimit nga anëtarët e shoqërisë së thjeshtë, për sa kohë nuk janë të specifikuar në mënyrë eksplicite në ligj, duhet të trajtohen njësoj si rasti i të ardhurave të realizuara nga “tregtari si person fizik”. Si rrjedhim nuk kanë detyrimin që të deklarojnë në deklaratën vjetore të të ardhurave (DIVA) sipas ligjit nr.8438/1998. Këtë konkluzion konfirmon edhe shkresa e Drejtorisë së Përgjithshme e Tatimeve Nr. 14775/3 prot, datë 01.08.2019 në të cilën, ndërmjet të tjerave, parashtrohet se: “ *b. Detyrimi i ortakëve*

për përfshirje në DIVA të fitimit të mbetur pas tatimit në shoqërinë e thjeshtë, nuk është përmendur në mënyrë eksplicite në nenin 13/2 të ligjit.”

77. Si rrjedhim KED vlerëson se kjo “mungesë informacioni”, e konstatuar nga ILDKPKI në raportin e saj lidhur me mosdeklarimin në deklaratën vjetore të të ardhurave (DIVA) të pjesës së saj të fitimit nga kandidatja Eris Hysi në shoqërinë e thjeshtë “H.....”, nuk mund të përbëjë mungesë deklarimi, apo deklarim të pasaktë të pasurisë/të ardhurave nga kandidatja Eris Hysi pasi vetë legjislacioni tatimor nuk parashikon një detyrim të qartë për këtë kandidatë për ti deklaruar këto të ardhura në deklaratën e të ardhurave vjetore. Ky përfundim konfirmohet dhe me faktin që vetë organi i specializuar dhe i ngarkuar nga ligji për zbatimin dhe kontrollin e legjislacionit tatimor, nuk ka gjetur asnjë problem apo mangësi në deklaratimet e kandidatës Eris Hysi nga viti 2014 e në vijim.

78. Për sa i përket gjetjes së ILDKPKI -së, që ka të bëjë me pikëpyetjen nëse janë paguar në mënyrë korrekte detyrimet tatimore lidhur me blerjen e apartamentit me adresë “K.....D.....” Tiranë, Këshilli vlerëson se kjo gjetje nuk mund të merret në konsideratë pasi detyrimi i taksës për shitjen, të cilit i referohet ILDKPKI, nuk është një detyrim që legjislacioni fiskal ja ngarkon blerësit, referuar nenit 8, shkronja dh) të ligjit nr. 8438/2008 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar. Kjo është një taksë që paguhet nga personi që gjeneron të ardhura, pra në çdo rast nga Shitësi. Në këto kushte, nuk mund të ngarkohet asnjë qytetar me përgjegjësi për detyrime të supozuara të një pale tjetër në kontratë. Gjithashtu, duhet të mbahet parasysh që edhe për kontratën e kalimit të të drejtave nga një qytetar tjetër tek kandidatja (përpara se të regjistrohej sendi i paluajtshëm, apartament), ligji nuk parashikon ndonjë detyrim për palën që i cedohen të drejtat e blerësit eventual, pra të kandidatës në rastin konkret.

79. Për sa i përket mangësive në dokumentacion të konstatuara nga ILDKPKI për të ardhurat nga paga në “H.....” për periudhën 2003-2008, Skkurt 2008 –Mars 2019, kandidatja ka paraqitur pranë KED dokumentacion të plotë nga ISSH, e cila nuk ka qënë disponibël nga ISSH për tu dërguar pranë ILDKPKI në kohën e përgatitjes së raportit. Gjithashtu kandidatja Eris Hysi ka paraqitur dokumentacion justifikues edhe për të ardhurat e saj si eksperte në Institutin e S.N. në shumën prej 1955 USD.

80. Bazuar në arsyetimet mbi rrethanat e faktit dhe ligjin e zbatueshëm si më sipër, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi çmon se gjetjet e ILDKPKI nuk janë rezultat i një hetimi të thelluar dhe ezaurues të pasurisë së kandidatës dhe burimeve të të ardhurave të saj, për rrjedhojë nuk mund të merren për bazë. Në kushtet kur kandidatja Eris Hysi paraqiti provat shtesë të cituara më lart dhe pasi Këshilli bëri një hetim të thelluar të paqartësive dhe pikëpyetjeve të ngritura në raportin e ILDKPKI-së, arrin në konkluzionin se kandidatja ka bërë deklarim të saktë në përputhje me ligjin të pasurisë dhe interesave të saj.

81. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në lidhje me kandidaten Eris Hysi e ka kaluar çështjen për shqyrtim vetëm me kriterin e pasurisë. Meqenëse Këshilli vendosi lejimin e kandidimit të kandidatës Eris Hysi në lidhje me këtë kriter, si dhe duke patur parasysh që nuk kishte gjetje të tjera sa i përket kësaj candidate, gjithashtu procedoi më tej me vendimmarrje pa riçelur hetimin për kushtet dhe kriteret e tjera ligjore të kandidimit.

82. Lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, kandidatja Eris Hysi ka dorëzuar në afat formularin e vetëdeklarimit sipas ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të cilin, Këshilli ia ka përcjellë për verifikim dhe kompetencë sipas ligjit Prokurorisë së Përgjithshme.

83. Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr. 1123/68 prot., datë 03.05.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidaten Eris Hysi, duke ardhur përfundimet se *“Subjekti deklarues Eris Hysi, kandidatë për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, nuk përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2 të ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”*”.

84. Prandaj, nisur nga rezultatet e kontrollit të ushtruar nga Prokuroria e Përgjithshme sipas ligjit, Këshilli vjen në përfundimin se, kandidatja Eris Hysi, krahas plotësimit të saktë të formularit të vetëdeklarimit, përmbush kushtin e parashikuar nga shkronja “ç” e nenit 199 të ligjit nr. 115/2016, pra që kandidati “ç) nuk është dënuar më parë për kryerjen e një vepre penale”. Për rrjedhojë, lidhur me këtë kriter, në zbatim të nenit 236 të ligjit nr. 115/2016, kjo candidate nuk gjendet në kushtet që mund të sjellin ndalimin e kandidimit.

85. Në vijim të procedurave të verifikimit të integritetit, kandidatja Eris Hysi ka dorëzuar në afat formularin e aplikimit “Për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta” parashikuar në ligjin nr. 45/2015, të cilin, Këshilli ia ka përcjellë për verifikim dhe kompetencë sipas ligjit Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.

86. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, me shkresën nr. 550/4 prot., datë 03.05.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidaten Eris Hysi, duke ardhur përfundimet se: *“Për zonjën Znj. Eris Shaban Hysi, nga verifikimet e kryera deri tani, nuk figurojnë të ketë materiale, në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, në emër të tyre, sipas Nenit 29, pika 2 të ligjit nr. 45/2015, “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”*.

87. Prandaj, nisur nga rezultatet e kontrollit të ushtruar nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, Këshilli vjen në përfundimin se kandidatja Eris Hysi, krahas plotësimit të saktë të formularit përkatës të aplikimit, përmbush kushtet e parashikuara nga ligji nr. 45/2015 për pastërtinë e figurës së funksionarit kushtetues në lidhje me sjelljen dhe veprimtarinë tij përpara muajit korrik 1991. Për rrjedhojë, lidhur me këtë kriter, në zbatim të nenit 236 të ligjit nr. 115/2016, kjo candidate nuk gjendet në kushtet që mund të sjellin ndalimin e kandidimit.

88. Gjithashtu, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi verifikoi, nëpërmjet informacionit të sjellë sipas ligjit nga organe kompetente ligjzbatuese si Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, Shërbimi Informativ i Shtetit, Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes dhe Shërbimi i Kontrollit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave pranë Ministrisë së Brendshme, nëse kandidatja Eris Hysi *“ka lidhje ose kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar”*. Ky verifikim përbën standardin kushtetues dhe ligjor tashmë të vendosur për figurën dhe integritetin e funksionarëve kushtetues të sistemit të drejtësisë, përpara zgjedhjes dhe gjatë ushtrimit të funksionit, pas ndryshimeve të Kushtetutës në vitin 2016, duke pasur parasysh ato të përcaktuara edhe në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës, si edhe në ligjet e tjera të nxjerra në pajtim me të, përfshirë ligjin nr. 84/2016, pra mbi të njëjtat standarde dhe interpretim të këtij kriteri në procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

89. Shërbimi i Kontrollit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave pranë Ministrisë së Brendshme, me shkresën nr. 730/1 prot., datë 20.05.2019, ka përcjellë pranë Këshillit të

Emërimeve në Drejtësi informacionin e kërkuar, të cituara më sipër, nga ku rezulton se, në lidhje me kandidaten Eris Hysi: *“Nuk figurojnë të evidentuar për veprimtari kriminale”*.

90. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, me shkresën nr. 1553 prot., datë 10.06.2019, ka përcjellë pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi informacionin e klasifikuar e të përpunuar sipas standardeve ligjore dhe profesionale për këtë kategori informacionesh, të dërguara nga agjencitë ligjzbatuese të cituara më sipër, nga ku rezulton se: *“Nuk disponohen materiale implikuese ose kompromentuese për integritetin e figurës së znj. Eris Shaban Hysi.*

91. Gjithashtu, edhe në lidhje me kushtin e kandidimit të parashikuar nga shkronja “ë” e pikës 1 të nenit 199 të ligjit nr. 115/2016, pra që kandidati “nuk është bashkëpunëtor, informator ose agent i shërbimeve të inteligjencës”, në përgjigje të kërkesës për informacion të Këshillit, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, edhe nëpërmjet shkresës nr. 2578 datë 02.08.2019 sqaron se për kandidaten Eris Hysi nuk ka të dhëna të tjera për të përcjellë të ndryshme nga ato të dërguara me shkresën nr. 1545 prot datë 10.06.2019.

92. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, bazuar në njohjen dhe shqyrtimin e informacionit të klasifikuar të dërguar nga agjencitë ligjzbatuese, vjen në përfundimin se, edhe për këtë kriter, në zbatim të nenit 236 të ligjit nr. 115/2016, kandidatja Eris Hysi nuk gjendet në kushtet që mund të sjellin ndalimin e kandidimit.

93. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit, në zbatim të shkronjave “b”, “d” dhe “dh” të pikës 1, të nenit 199 të ligjit nr. 115/2016, të nenit 237 dhe 240 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikave 91-93 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, Këshilli shqyrtoi dokumentacionin e depozituar nga vetë kandidatja Eris Hysi në momentin e kandidimit pranë organit të emërtesës që ka shpallur vendin vakant, shpjegimet dhe dokumentet shtesë të paraqitura nga kandidati mbi kërkesën e Këshillit, si edhe përgjigjet nga informacionet e kërkuara nga institucionet publike dhe subjektet private ku kandidatja ka ushtruar funksione publike ose veprimtari private profesionale apo ku gjenden të dhëna lidhur me ushtrimin e detyrave dhe veprimtarinë profesionale të saj.

94. Në lidhje me kushtin e kandidimit të parashikuar nga shkronja “b” e pikës 1 të nenit 199 të ligjit nr. 115/2016, pra që kandidati të ketë *përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi me diplomë “Master i shkencave”, ose diplomë të njësuar me të, ose studimet universitare për drejtësi jashtë shtetit dhe të ketë marrë një diplomë të njësuar, sipas rregullave për njësimin e diplomave, të parashikuara me ligj*, nga dokumentacioni i shqyrtuar rezulton se, kandidatja Eris Hysi ka përfunduar studimet dhe është diplomuar në vitin 2001 si Juriste, në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës. Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 ky lloj arsimimi kualifikohet si arsim i lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë. Për rrjedhojë kandidatja Eris Hysi nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas dispozitave të sipërcituara.

95. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 3 e nenit 147/d të Kushtetutës dhe shkronja “c” e pikës 1 të nenit 199 të ligjit nr. 115/2016, pra që kandidati të ketë *ka jo më pak se 15 vjet përvojë pune në profesion si jurist*., nga dokumentacioni i shqyrtuar, përfshirë jetëshkrimin, librezën e punës, shkresa e vërtetime të lëshuara nga organet kompetente të emërtesës etj., që janë të administruara në dosjen e kandidimit, ndërmjet të tjerave, rezulton se kandidatja Eris Hysi ka ushtruar veprimtari profesionale si:

- a) Avokate, Partnere, Administratore, Studio e Avokatisë Haxhia & Hajdari, Shtator 2001 e në vazhdim
- b) Anëtare e Komisionit Ad Hoc për verifikimin dhe vlerësimin paraprak të kandidaturave për anëtar të KLGJ dhe KLP nga fusha e avokatisë Avokati i Popullit, Tiranë Shkurt 2017
- c) Eksperte e Pavarur Ministria e Kulturës Nëntor 2015 – Janar 2016
- ç) Eksperte e Pavarur Shoqata e Grave me Probleme Sociale, në kuadër të projekteve IPA ADRIATIKA me mbikqyrje nga Ministria e Integritimit 1 Tetor 2012 – 31 Mars 2013
- dh) Eksperte ligjore GTZ Gusht – Tetor 2008
- d) Pjesëmarrëse vëzhguese në seminarin EUROMED Ministria e Jashtme e Çekisë, Pragë, Çeki 16-17 Qeshor 2008
- dh) Trajnere Dhoma e Kombëtare e Avokatisë, Këshillit Europës 26, 27 Maj 2008, 19-20 Shtator 2008 26-27 Shtator 2008
- e) Përfaqësuese e Dhomës Kombëtare të Avokatisë Dhoma e Kombëtare e Avokatisë Kroate dhe Këshilli i Evropës, Zagreb, Kroaci 17-20 Tetor 2006
- ë) Përfaqësuese e Dhomës Kombëtare të Avokatisëprojekti Cards, Këshilli i Evropës, Budva, Mali i Zi 14-17 Qershor 2005
- f) Përfaqësuese e Dhomës Kombëtare të Avokatisëprojekti Cards, Këshilli i Evropës, akviteti i zhvilluar në Beograd, Serbi 8-10 Qershor 2005
- g) Përfaqësuese e Dhomës Kombëtare të Avokatisë Dhoma e Avokatëve Selanik, Selanik, Greqi 4-5 Shkurt 2005
- gj) Përfaqësuese e Dhomës Kombëtare të Avokatisë Këshilli i Evropës në bashkëpunim me Dhomën e Avokatëve të Ankarasë 16-19 Dhjetor 2003
- i) Përfaqësuese e Dhomës Kombëtare të AvokatisëKëshilli i Evropës 5-4 Shtator 2002

96. Bazuar në gjetjet e cituara më sipër, Këshilli konstaton se kandidatja Eris Hysi ka ushtruar së paku për 15 vjet veprimtari profesionale nga ato të parashikuara si kusht për lejimin e kandidimit nga pika 3 e nenit 147/d të Kushtetutës dhe shkronja “c” e pikës 1 të nenit 199 të ligjit nr. 115/2016.

97. Për sa i përket kushtit të kandidimit të parashikuar nga pika 3 e nenit 147/d të Kushtetutës dhe shkronja “dh” e pikës 1 të nenit 199 të ligjit nr. 115/2016, pra që kandidati *nuk ka mbajtur funksione politike në administratën publike ...*, sikurse parashtrohet më sipër, si edhe nga jetëshkrimi dhe aktet e administruara në dosjen e kandidimit për veprimtaritë e tjera të ushtruara, Këshilli konstaton se kandidatja Eris Hysi nuk ka ushtruar funksione politike në administratën publike (gjatë 10 viteve të fundit të kandidimit). Për rrjedhojë kandidatja Eris Hysi nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas dispozitave të sipërcituara.

98. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 3 e nenit 147/d të Kushtetutës dhe shkronja “dh” e pikës 1 të nenit 199 të ligjit nr. 115/2016, pra që kandidati *të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit përpara kandidimit* nga shqyrtimi i jetëshkrimit dhe të dhënave që rezultojnë nga aktet e administruara në dosjen e kandidimit, sikurse janë korrespondenca me partitë politike, Këshilli konstaton se kandidatja Eris Hysi nuk ka mbajtur pozicione drejtuese në parti politike (gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit). Për rrjedhojë kandidatja Eris Hysi nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas dispozitave të sipërcituara.

99. Në shkronjën “d” të pikës 1 të nenit 199 të ligjit nr. 115/2016, si kusht kandidimi përcaktohet që kandidati *nuk është pushuar nga puna më parë për shkaqe disiplinore dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi në momentin e kandidimit*. Nga dokumentacioni i shqyrtuar, përfshirë jetëshkrimin, librezën e punës, shkresa e vërtetime të lëshuara nga organet

kompetente të emërtesës etj., që janë të administruara në dosjen e kandidimit, Këshilli konstaton se kandidatja Eris Hysi nuk rezulton të jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore. Po kështu, nuk rezulton që kandidatja të ketë masa disiplinore në fuqi të lidhura me veprimtarinë e saj. Për rrjedhojë kandidatja Eris Hysi nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas kësaj dispozite.

100. Nisur nga sa analizohet dhe arsyetohet më sipër, bazuar në gjetjet dhe të dhënat e konstatuara gjatë procedurës së verifikimit që rezultojnë nga aktet dhe dokumentacionin që përmban dosja e kandidimit, në interpretim dhe zbatim të ligjit të zbatueshëm për kushtet dhe kriteret e kandidimit për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vjen në përfundimin se duhet të vendoset lejimi i kandidimit të kandidatës Eris Hysi në vendin vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, të shpallur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në datën 01.03.2019.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të nenit 199, pikës 3 të nenit 229 dhe pikës 4 të nenit 235, pikës 5 të nenit 236, pikës 3 të nenit 237 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si edhe të shkronjës “a” të pikës 50 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

VENDOSI:

1. Lejimin e kandidimit të kandidatës Eris Hysi, në vendin vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, të shpallur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në datën 01.03.2019.
2. Në zbatim të nenit 238 të Ligjit nr. 115/2016, ky vendim i njoftohet kandidatës Eris Hysi.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

KRYETARI
Ardian DVORANI



MENDIM PAKICE

Në anëtarët e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi **Margarita Buhali, Vitore Tusha dhe Arta Marku** kemi votuar kundër vendimit të marrë nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi me nr.106 dt.02.08.2019 për lejimin e kandidimit të znj. Eris Hysi në pozicionin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Për mendimin tonë znj.Eris Hysi nuk plotëson kushtet ligjore të kandidimit sipas nenit 235 të ligjit nr.115/2016. Në zbatim të pikës 47 të vendimit nr.4/2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi paraqesin mendimin në pakicë kundër vendimit nr.106 dt.02.08.2019 të KED.

Nga hetimi i realizuar në kuadër të verifikimit të pasurisë së kandidatet Eris Hysi si nga ILDKPKI dhe dokumentacioni i dorëzuar pranë KED janë konstatuar gjetje që kanë lidhje me;

- deklarin e pasaktë të të ardhurave të përfituara nga kandidatja nga ndarja e fitimit në shoqëri e thjeshtë, ku ajo është anëtare,
- deklarimin e këtyre të ardhura në organin tatimor për cdo vit si pjesë e DIVA (deklaratë individuale vjetore e të ardhurave) për personat që sigurojnë të ardhura bruto mbi 2 000 000 lekë në vit,
- pagesën e detyrimeve tatimore nga ndarja e fitimit,
- mungesën e dokumentave justifikuese që konfirmojnë ndarjen të fitimit të shoqërisë në llogari të kandidatës në vitin 2018 për shumën prej 45000 euro dhe pagimin e tatimit të fitimit dhe të tatimit mbi të ardhurat personale për këtë shumë.

Nga ILDKPKI është konstatuar deklarim i pasaktë lidhur me të ardhurat nga shpërndarja e fitimit pranë shoqërisë , pasi subjekti ka deklaruar dhe dokumentuar nga kjo shoqëri fitimin pas tatimit në shumën totale prej 16 112 653 lekë për periudhën 2013-2018, ndërsa referuar deklaratave Individuale vjetore të të ardhurave sipas DRT Tiranë të ardhurat nga burime të tjera të deklaruara nga kandidati Eris Hysi për të njëjtën periudhë janë në shumën 9340292 lekë.
Mungon informacioni nëse janë paguar detyrimet tatimore për këto të ardhura.

Lidhur me këtë gjetje të ILDKPKI kandidatja ka kundërshtuar se: ***Nuk ka detyrim të deklarojë të ardhurat e fituara nga shpërndarja e fitimit të shoqërisë së thjeshtë në deklaratën vjetore të të ardhurave pranë organit tatimor, pasi sipas saj pozicioni i personit fizik tregtar dhe i anëtarit të shoqërisë së thjeshtë është i njëjtë.*** Nisur nga ky qëndrim kandidatja ka theksuar se sipas pikës 2.3.3 të udhëzimit nr.5 dt.30.01.2006 fitimi i realizuar në shoqërinë e thjeshtë nuk duhet të përfshihet në të ardhurat e realizuara për qëllime të deklarimit DIV dhe për këtë arsye nuk është përfshirë në deklaratë.

Nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi u konstatua se deklarimi i të ardhurave të tjera pranë tatimeve në deklaratën vjetore të të ardhurave përkonin me të ardhurat e deklaruara nga shpërndarja e fitimit në shoqërinë për vitet 2013 e 2014 dhe më pas ndryshonin duke krijuar një diferencë në mosdeklarim pranë organeve tatimore të një shume prej afërsisht 7 000 000 lekë. Për këtë ju kërkua sqarime kandidatës se përse kishte ndodhur ky ndryshim i deklarimeve të saj për të ardhurat në vite pranë Drejtorisë së tatimeve?

Lidhur me këtë konstatim kandidatja është përgjigjur se: *këto të ardhura gabimisht janë deklaruar në rubrikën të ardhurat nga dividendi pasi nga organi tatimor nuk ishin sqaruar se çfarë të ardhurash janë subjekt i deklaratës individuale vjetore të të ardhurave. **Në Maj të vitit 2014 nga organi tatimor është sqaruar kjo çështje me ndryshimet e pasqyruara në udhëzimin nr.5 dt.30.01.2016 të ndryshuar.** Sipas ndryshimit të ardhurat e tatueshme për qëllimet të deklarimit individual të të ardhurave nuk përfshijnë fitimin neto të personave fizik tregtar pavarësisht nëse janë subjekt i tatimit mbi fitimin ose tatimit të thjeshtuar. Gjithashtu*

kandidatja pretendon se pozicioni i personit fizik tregtar është i njëjtë me atë të anëtarit të shoqërisë së thjeshtë.

Gjithashtu në vijim të sqarimeve të dhëna në datën 05.07.2019 kandidatja ka shtuar se : Shoqëria e thjeshtë është bashkimi i licencave të tre ortakëve dhe në bazë të ligjit trajtimi është i njëjtë me personin fizik që merr fitimin pas pagimit të tatimit përkatës në mbyllje të vitit financiar, fitimi i marrë në këtë formë përjashtohet nga ndonjë taksë apo tatim tjetër dhe i shpërndahet personit fizik. Në ligjin nr.8438 dt.24.12.1998 neni 2 germa g pika iv është dhënë përkufizimi i ortakërisë dhe ky organizëm është vetëm subjekt i tatimit mbi fitimin dhe nuk ndan dividend të tatueshëm por vetëm fitim. Në përmbledhje kandidatja pretendon se nuk ka detyrim të bëjë deklarime në tatime për të ardhurat nga fitimet si rezultat i pjesëmarrjes si ortakë në shoqërinë e thjeshtë, sikurse është organizuar shoqëria “H.....”, ku ajo aktualisht bën pjesë si ortakë me 15 %.

Pas analizës së gjetjeve të ILDKPKi, shpjegimeve të kandidatet, dhe konsultimin me kuadrin ligjor e nënligjor, që rregullon të ardhurat personale dhe mënyrën e deklarimit të tyre në Deklaratën vjetore të të ardhurave, ne anëtarët në pakicë vlerësojmë bindëse gjetjen e ILDKPKI se për të ardhurat e përfituara si ortakë nga ndarja e fitimit në shoqërinë e thjeshtë, **kandidatja ka bërë deklarime të pasakta dhe nuk provohet që ato të jenë të ardhura të ligjshme për të cilat janë paguar rregullisht tatimet nga sa më poshtë;**

1-Pretendimi i kandidates se ka ndryshuar qëndrimin lidhur me deklarimin e të ardhurave të fituara nga shpërndarja e fitimit të shoqërisë së thjeshtë në deklaratën vjetore të të ardhurave pas viteve 2013-2014, për shkak të sqarimit të dhënë në muajin Maj të vitit 2014 nga organi tatimor gjendet jobindës. Kështu rezulton se vetë kandidatja ka deklaruar saktë të gjitha të ardhurat e fituara nga pjesëmarrja e saj në fitimet e shoqërisë së thjeshtë në kolonën “të ardhura të tjera bruto” të deklaratës vjetore të të ardhurave të vitit 2014 dhe jo në kolonën të ardhura nga dividenti”. Kjo deklaratë është plotësuar dhe dorëzuar në muajin prill të vitit pasardhës, që është ai 2015. Në rast se kandidatja do të ishte sqaruar në muajin Maj 2014 se nuk duhet të ishte bërë ky deklarim të ardhurash, atëherë ajo nuk do i kishte deklaruar ato në kohën kur plotësoi deklaratën vjetore, që ishte viti 2015. Ndërkohë nuk rezulton që kandidatja të ketë përfitur të gjitha të ardhurat nga fitimi në shoqëri para muajt Maj 2014 pasi nga lista e dokumentave të paraqitura prej saj në KED rezulton se në favor të saj janë lëvruar fitime nga shoqëria në periudhën Janar, Prill, Gusht, Dhjetor 2014.

2-Kandidatja pretendon se të ardhurat nga fitimet e ortakut në shoqëritë e thjeshta është i përjashtuar nga pagimi i tatimeve mbi të ardhurat sipas nenit 2.3.3 të udhëzimit nr.5 dt.30.01.2006. Pikërisht për këtë shkak ajo nuk i ka deklaruar pas vitit 2014. Ky pretendim vlerësohet i pabazuar. Duke qënë se kandidatja ka pretenduar se shoqëria e thjeshtë nuk është subjekt i shpërndarjes së dividendëve, sqarohet se kandidatja për vitet 2013 e 2014 ka plotësuar të ardhurat e përfituara nga shpërndarja e fitimit në shoqëri në kolonën të ardhura bruto të tjera-kolona nr.14 (të ardhura bruto të tjera të padeklaruara më lart) dhe jo në kolonën të ardhurat nga dividenti. Edhe në vitet 2015-2018 ajo përsëri ka bërë deklarime në Deklaratën vjetore të të ardhurave në kolonën e të ardhurave bruto të tjera por pas vitit 2014 ato nuk përkojnë me fitimet që ajo pretendon se ka fituar nga ortakëria në shoqërinë e thjeshtë, madje në vitet 2015-2017 diferenca është e dukshme. Megjithëse sqaron se ajo nuk ka detyrime të deklarojë të ardhurat nga pjesëmarrja në fitimin e shoqërisë në deklaratën vjetore të të ardhurave, nuk jep shpjegime se cili është burimi i të ardhurave të tjera bruto të deklaruara për vitet 2015 e vijim në Deklaratën vjetore të të ardhurave. Konstatohet se kandidatja ka deklaruar vlera të konsiderueshme në rubrikën “të ardhurave bruto” të tjera konkretisht për vitin 2015 në vlerën 5 238 644 lekë me një fitim neto prej 4 452 847 lekë, ndërsa për vitet 2016-2017 të ardhurat e deklaruara në kolonën “të ardhura bruto të tjera” të deklaratës janë dukshëm më të vogla se

fitimet e pretenduara, ndërkohë që për vitin 2018 përsëri përkon e ardhura në përqindje e kandidates në fitimin në shoqëri prej 154906 lekë me atë të deklaruar në DIVA në vlerën 180000 lekë dhe pas tatimit 153000 lekë. Këto mënyra të ndryshme të deklarimit të të ardhurave nga fitimi ndër vite i kandidates e rrëzojnë pretendimet e saj se ajo nuk duhet të deklaronte në DIVA të ardhurat nga fitimi i shoqërisë, pasi ajo vetë ka bërë deklarimin e tyre pjesërisht.

Në rast se do të pranohej arsyetimi i kandidates se ajo nuk kishte detyrimin për deklarimin e të ardhurave nga shpërndarja e fitimit në shoqëri në deklaratën vjetore të të ardhurave, kandidatja duhet të jepte një shpjegim për burimin e të ardhurave bruto të deklaruara prej saj për vitet 2015 -2018 në DIVA, të ndryshëm nga konstatimet e ILDKPKI sipas të cilës burimi i këtyre të ardhurave ka qënë fitimi në shoqëri, por që kandidatja nuk i ka deklaruar në deklaratë vjetore para organeve tatimeve në mënyrë të saktë. Duke qënë se kandidatja nuk ka dhënë asnjë shpjegim për ndonjë burim të ndryshëm të këtyre **të ardhurave të tjera bruto**, atëherë mbetet, që këto të ardhura të jenë gjeneruar nga shpërndarja e fitimit në shoqëri, por që janë deklaruar më pak para organeve tatimore nga kandidatja, se të ardhurat reale të përfituara.

Një gjë e tillë konfirmohet edhe me faktin se të ardhurat e tjera për vitet 2015-2018 si ato nga paga në shoqërinë e thjeshtë, të ardhurat në formën e honorarit mujor si anëtare e bordit të institucionit financiar “F.....:..” ose mësimdhënia ajo i ka deklaruar në pjesë të tjera të deklaratës vjetore konkretisht në pjesën për të ardhura nga paga e shpërblimet. Të ardhurat vjetore nga këto subjekte janë dukshëm më të ulta se ato, që ajo ka marrë nga fitimi. Kështu konkretisht në vitin 2015 kandidatja ka deklaruar në kolonën e të ardhurave të tjera bruto shumën prej 5 238 644 lekë, tatimi 785 797 lekë fitimi neto 4452 847 lekë. Ndërkohë të ardhurat nga paga të saj për vitin 2015 kanë qënë 1 563 000 lekë në shoqërinë “.....”, nga “F.....” 854 612 lekë, 1275 euro nga një kontratë shërbimi me Ministrinë e Kulturës dt.19.11.2015, të ardhurat nga mësimdhënia në shkollën e avokatisë 1099 100 lekë pjesëtim me 7 vite pasi janë në total për periudhën 2011 -2017. Pra edhe në rast se do të mblidhen të gjitha këto të ardhura nga paga ose honoraret për vitin 2015 ato nuk kapin vlerën prej 5 238 644 lekë që kandidatja ka deklaruar në DIVA se ka përfituar të ardhura të tjera bruto për vitin 2015. Duke krahasuar të ardhurat e tjera, që ajo ka fituar në këtë vit me ato të deklaruara në DIVA rezulton se kandidatja ka deklaruar në DIVA në kolonën e të ardhurave të tjera bruto fitimin e marrë nga shpërndarja në shoqëri, por jo në vlerën reale, gjë që rrëzon përsëri pretendimin e saj se ajo nuk duhet të bënte deklarimin e fitimit të marrë nga shoqëria në DIVA pasi ishte person fizik.

Si rrjedhim të ardhurat e vetme, që ajo ka deklaruar në kolonën 14 të formularit të deklarimit të pasurisë të titulluar të ardhura bruto nga burime të tjera janë pikërisht të ardhurat, që ajo ka marr nga ndarja e fitimit në shoqëri, por që në fakt janë deklaruar shumë më pak se shumata, që ajo pretendon se realisht ka marr nga shoqëria në deklarimin e pasurisë së saj në ILDKPKI sipas viteve 2015-2018. Nga sa mësipër rezulton e provuar se kandidatja megjithëse pretendon se nuk duhet të deklaronte të ardhurat e marra nga ndarja e fitimit në deklaratën vjetore të të ardhurave, në fakt i ka deklaruar ato por jo në vlerën e duhur, gjë që tregon se shumata e të ardhurave nga fitimi e padeklaruar në organin tatimor prej afërsisht 7 000 000 nuk i është nënshtruar kontrollit tatimor për pagimin e tatimore. Mbi këtë bazë nuk vërtetohet ligjshmëria e përfitimit të këtyre të ardhurave sipas ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat personale”

3_Për sa i përket pretendimit nëse duhet apo jo kandidatja **të deklaronte të gjitha** të ardhurat e fituara prej saj nga ndarja e fitimeve si anëtare ose ortakë e shoqërisë, evidentohet ligji i zbatueshëm në këtë rast.

Kështu, kuadri ligjor i të ardhurave të tatueshme dhe të deklarueshme në deklaratën vjetore personale rregullohet nga ligji nr. 8438 dt.28.12.1998 dhe udhëzimi nr.5 dt.30.01.2006 i ndryshuar.

Kështu ligji nr.8438/1998 i ndryshuar parashikon;

Neni 2 “ për qëllimet e këtij ligji emërimi « tatimpagues » nënkupton çdo person që i nënshtrohet detyrimit të tatimit sipas këtij ligji; ku në termin person përfshihen i-një individ (person fizik jotregtar sipas kodit civil), një « person fizik » (person fizik tregtar), iii) një « person juridik » (shoqëri tregtare e themeluar sipas ligjit ”Për tregtarë dhe shoqëritë tregtare”, personat e tjerë juridikë të themeluar sipas Kodit Civil, të cilët ushtrojnë veprimtari fitimprurëse në Republikën e Shqipërisë, si dhe personat e tjere juridike të themeluar ose të njohur si të tillë me ligje të veçanta); (Ndryshuar me Ligj nr.10072,dt. 9.2.2009, Fl. Z. nr. 20, datë 04.03.2009). iv) një « ortakëri », si bashkim personash, fizikë dhe juridikë, për të kryer një veprimtari të përkohshme, të përbashkët me qëllim fitimi, që nuk krijohet si person juridik me vete në format e parashikuara nga ligji ”Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, nga Kodi Civil ose nga ligje të veçanta.

Neni 4

Të ardhurat nga një burim në Republikën e Shqipërisë, pa u kufizuar vetëm në to, do të përfshijnë të ardhurat si vijon:

ë) të ardhurat nga dividendët e shpërndarë nga një person juridik, rezident;

f) të ardhurat nga pjesët e fitimit, të paguar nga një ortakëri rezidente;

Neni 6 Tatimi mbi të ardhurat personale, **përfshin të gjitha llojet e të ardhurave të individëve**, të parashikuara nga Ligji.

Neni 7

1. **Individët rezidentë** i nënshtrohen detyrimit për tatimin mbi të ardhurat personale gjatë periudhës tatimore, **për të gjitha burimet e të ardhurave**, sipas parashikimeve të këtij kreu.

Neni 8

Për qëllime të tatimit mbi të ardhurat **personale**, merren si të ardhura të tatueshme:

b) të ardhurat që rrjedhin nga **fitimi i ortakut** apo i aksionerit në shoqërinë tregtare;

g) të ardhura të tjera, që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen, të realizuara nga individë rezidentë ose nga persona jorezidentë, por me burim në Republikën e Shqipërisë.

Neni 13/2 -1. Tatimpaguesi, në deklaratën vjetore të të ardhurave, jep të dhëna për të ardhurat bruto, në të cilat përfshihen: b) të ardhurat bruto nga dividenti për pjesëmarrje në shoqëri tregtare **apo nga veprimtaritë e biznesit;**

Udhëzimi nr. 5 dt.30.01.2006 i ndryshuar parashikon;

Në pikën 2.1 fusha e veprimit të udhëzimit: Tatimi mbi të ardhurat personale, **përfshin të gjitha llojet e të ardhurave të individëve**, të parashikuara nga Ligji.

Neni 2.3 i udhëzimit nr. 5/2006 parashikon se; Në zbatim të Nenit 8, të ardhura të tatueshme për qëllim të tatimit mbi të ardhurat personale, janë kategoritë e të ardhurave të mëposhtme:
2.3.3 Të ardhurat që rrjedhin nga fitimi i ortakut apo i aksionerit në shoqërinë tregtare (pika b)

e paragrafit 1. Në kuptim të kësaj pike, bëhet fjalë për të ardhurat që përfitojnë individët, në formën e ndarjes së fitimit nga ortakëritë, apo të dividendit nga shoqëritë tregtare. Në të ardhurat e tatueshme sipas kësaj pike nuk përfshihet fitimi neto (pas pagimit të tatimit mbi fitimin apo tatimit të thjeshtuar mbi fitimin mbi biznesin e vogël) i personave fizikë tregtarë, pavarësisht nëse këta të fundit janë subjekt i tatimit mbi fitimin apo tatimit të thjeshtuar mbi fitimin mbi biznesin e vogël. (Ndryshuar me Udhëzim Nr.14, dt. 23.05.2014. Botuar në Fl .Z Nr. 80, dt. 4 qershor 2014).

Neni 2.39... Nuk përfshihet në pikën “g” të nenit 8 të ligjit as fitimi neto i personave fizikë tregtarë, pavarësisht nëse ky i fundit i nënshtrohet tatimit mbi fitimin apo tatimit të thjeshtuar mbi fitimin mbi biznesin e vogël. Të ardhurat e personit fizik tregtar nga ushtrimi i aktivitetit tregtar taten vetëm sipas kreut III “Tatimi mbi fitimin” (nenet 16-32 të ligjit) në rastin e subjekteve me xhiro mbi 8 milionë lekë në vit dhe sipas ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, për subjektet me xhiro deri në 8 milionë lekë në vit. Personi fizik tregtar nuk ka personalitet juridik të ndryshëm nga individi (i regjistruar si tregtar), ndryshe nga rasti i shoqërive tregtare dhe ortakëve të saj individë dhe rrjedhimisht fitimi neto i personit fizik tregtar nuk konsiderohet si e ardhur personale e individit, subjekt i pikës “g” të nenit 8 të ligjit.

Kodi Civil

Neni 1074

Shoqëria është një kontratë me të cilën dy apo më shumë persona merren vesh për të ushtruar një aktivitet ekonomik, **me qëllim që të ndajnë fitimet** që rrjedhin prej tij. **Personi anëtar i shoqërisë** duhet të vërë në dispozicion të këtij aktiviteti para, sende apo shërbime.

Neni 1085

Përveç marrëveshjes së kundërt, çdo anëtar ka të drejtë të marrë pjesën e vet të fitimeve pas miratimit të raportit.

Neni 1086

Pjesët që u takojnë anëtarëve në fitimet ose në humbjet prezumohen në përpjesëtim me kuotat e kontribuara. Në qoftë se vlera e kontributeve nuk përcaktohet nga kontrata, caktohet nga gjykata. Në qoftë se kontrata përcakton vetëm pjesën e çdo anëtari në fitimet, në të njëjtën masë prezumohet se duhet të përcaktohet edhe pjesëmarrja në humbjet.

Duke iu referuar këtij kuadri ligjor, në anëtarët e KED në pakicë vlerësojmë se **të ardhurat e përfituara nga ndarja e fitimit nga ortakëritë përfshihet në të ardhurat personale, që duhet të deklarohet në deklaratën vjetore të të ardhurave sipas ligjit nr.8438/1998.** Kuptimi i ortakërive ka të bëjë me bashkimin e disa personave, fizik ose juridik. Nën këtë interpretim termi ortakëri përfshin edhe bashkimet e disa individëve në formën e shoqërive të thjeshta. Të ardhurat nga fitimi në ortakëri ndryshojnë nga dividendët, që shpërndahen te shoqëritë tregtare. Pikërisht për këtë qëllim në udhëzimin nr.5 dt.30.01.2006, pika 2.3.3 të ardhurat, që përfitojnë individet nga ndarja e fitimit në ortakëri parashikohet si alternativë e ndarjes së dividendit, që vepron te shoqëritë tregtare. Kjo do të thotë se ndarja e fitimit për ortakëritë përfshihet në të ardhurat, që duhet të deklarohet për efekt të plotësimit të deklaratës vjetore të të ardhurave nga vetë ortaku. Këtë llogjikë ndjekin dhe nenet 4 e vijues të ligjit nr.8438/1998, ku parashikohet se përfshihen te të ardhurat krahas të ardhurat nga shpërndarja e dividendëve dhe pagesat e fitimit nga një ortakëri rezidente. Duke qënë se dividendët zbatohen te shoqëritë tregtare atëherë të ardhurat nga ndarja e fitimit në ortakëri ka të bëjë me ndarjen e fitimeve midis ortakëve, që nuk kanë formën e personave juridik shoqëri tregtare të parashikuara nga ligji për shoqëritë tregtare. Përrjashtimi i nenit 2.3.3 të udhëzimit nr.5 dt.30.01.2006 i ndryshuar ka të bëjë me të ardhurat e përfituara nga fitimi neto i personave fizik

tregtar në ato raste kur nuk kemi ndarje të fitimit midis ortakëve pasi personi fizik tregtar, që i realizon këto të ardhura pas pagimit të tatim fitimit është një person i vetëm. Si rrjedhim fitimi i realizuar prej tij i përket këtij personi fizik, i cili mund ta tërheq ose ta investojë përsëri në shtim të aktivitetit.

Te personi fizik tregtar nuk vepron instituti i ndarjes së fitimit, ndërsa te shoqëritë e thjeshta pavarësisht se ato nuk konsiderohen persona juridik shoqëri tregtare zbatohet instituti i ndarjes së fitimit në raport me kuotën, që disponojnë anëtarët-ortakët në shoqërinë e thjeshtë. Prandaj për aq kohë sa zbatohet instituti i ndarjes së fitimit neto, ortakët e shoqërisë së thjeshtë ose të ashtuquajturit anëtarë të saj janë të detyruar ta deklarojnë në deklaratën e të ardhurave vjetore fitimin e përvetsuar nga shpërndarja e fitimit.

Me qëllim për të shmangur çdo lloj konfondimi me ndarjen e dividendëve në formularin e deklaramit të të ardhurave vjetore është parashikuar një rubrikë për të ardhura bruto të tjera. Është pikërisht kjo rubrikë, që është plotësuar nga vetë kandidatja rregullisht në përputhje me të ardhurat në fitime në vitet 2013 - 2014 ndërsa në vitet pasardhëse përsëri është plotësuar por ka pasur ndryshime në raport me të ardhurat, që ajo deklaron në ILDKPKI se ka fituar nga ndarja e fitimeve midis ortakëve të shoqërisë së thjeshtë. Kështu në deklaramin e pasurisë në ILDKPKI ajo ka deklaruar të ardhura nga fitimi në ortakëri 16 112653 lekë për periudhën 2013-2018, ndërsa nga deklaratat vjetore të të ardhurave të ardhurat nga burime të tjera të deklaruara prej saj janë 9 340 292 lekë, pra me një diferencë prej afërsisht 6 772 361 lekë, që nuk është deklaruar si e ardhur në deklaratën vjetore të të ardhurave.

Në përputhje me parashikimin e nenit 6 të ligjit nr.8438/1998 dhe udhëzimit nr.5/2006 rezulton se qëllimi i këtij kuadri ligjor është aplikimi i tatimit mbi të ardhurat personale të siguruara nga individët. Pra, **subjekt i zbatimit të këtij ligji në mënyrë të drejtëpërdrejtë është individi, që plotëson deklaratën vjetore të të ardhurave personale.** Duke qënë se personi fizik tregtar nuk ka një personalitet juridik të ndryshëm nga individi i regjistruar si tregtar, të ardhurat nga fitimi neto i këtij personi fizik nuk konsiderohet si e ardhur personale sipas nenit 8/g të ligjit nr.8438/1998. Ato përfshihet në të ardhurat e personit fizik pasi personi fizik tregtar është i njëjtë me individin në emër, të të cilit është regjistruar veprimtaria. Nuk ndodh kështu në rastin e shoqërive të thjeshta, pasi shoqëria e thjeshtë si subjekt tregtar i tatueshëm ka një personalitet të ndryshëm juridik nga anëtarët, që e kanë themeluar. Një gjë e tillë del nga përkufizimi i shoqërisë së thjeshtë sipas nenit 1074 të K.Civil, ku parashikohet se ajo krijohet me marrëveshjen e disa personave (anëtar të shoqërisë), që merren vesh për të ushtruar një aktivitet ekonomik me qëllim ndarjen e fitimeve. Pikërisht për këtë shkak ky organizëm i bashkimit të disa personave mban emërtimin shoqëri e thjeshtë dhe individët, që marrin pjesë në të gëzojnë një përqindje të caktuar pjesëmarrje në fitimet e humbjet e shoqërisë në varësi të kuotave të kontribuara prej tyre në kontratën e krijimit e shoqërisë së thjeshtë. Si rrjedhim në shoqërinë e thjeshtë edhe pse është bashkim i disa individëve, personalitetit i shoqërisë nuk është i njëjtë me atë të individit, që merr pjesë në shoqëri për qëllim të zbatimit të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”. Ata konsiderohen anëtar ose ortak të saj. Prandaj të ardhurat nga fitimi neto i shoqërisë së thjeshtë marrin vlerën e të ardhurave personale kur ndahet në favor të individëve pjesëmarrës në shoqërinë e thjeshtë. Për këtë shkak të ardhurat e siguruara nga ndarja e fitimit midis anëtarëve të shoqërisë së thjeshtë konsiderohet e ardhur personale e individit anëtar dhe i nënshtrohet zbatimit të ligjit “Për të ardhurat personale: si në deklaram dhe në tatim.

Veç sa mësipër, deklarami i të ardhurave është e parashikuar 13/2 të ligjit nr.8438/1998 ku parashikohet **detyrimi i individit të deklarojë të ardhurat bruto nga veprimtaritë e biznesit,** ku përfshihet edhe të ardhurat e fituara nga shoqëritë e thjeshta. Ky detyrim për deklaram rrëzon pretendimet e kandidatës, që nuk duhet të deklaronte si të ardhur pjesën e fitimit të marr individualisht prej saj nga shpërndarja e fitimit të shoqërisë së thjeshtë. Detyrimi

i deklarimit të cdo të ardhureje rrjedh edhe nga vetë formulari i deklarimit vjetor të të ardhurave ku në rubrikën 14 të tij janë të parashikuar të ardhura bruto nga burime të tjera, gjë që nënkupton se duhet të deklarohen të gjitha të ardhurat e fituara individualisht nga subjekti, pavarësisht se ato do i nënshtrohen apo jo tatimit mbi të ardhurat.

Po ashtu në nenin 8 të ligjit nr.8438 është parashikuar se duhet të deklarohen si të ardhura të tatueshme **g) të ardhura të tjera, që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen, të realizuara nga individë rezidentë ose nga persona jorezidentë, por me burim në Republikën e Shqipërisë.** Në përputhje me këtë dispozitë edhe nëse do të pranohej termi ortakëri nuk përfshin shoqëritë e thjeshta, përsëri individit mban detyrimin të deklarojë të ardhurat e tjera që nuk mund të identifikohen me një emërtim të posaçëm në nenin 8, ku përcaktohen të ardhurat e tatueshme. Pra detyrimi për deklarim mbetet pavarësisht pretendimeve të individit nëse ato do të taten apo jo. Duke qënë se personaliteti i shoqërisë së thjeshtë është i ndryshëm nga i individit anëtar të shoqërisë, atëherë kandidatja mbart detyrimin **për deklarimin e tij** në deklaratën vjetore të të ardhurave.

4-Arsyetimi i shumicës se kandidatja si anëtare e shoqërisë së thjeshtë gëzon statusin e personit fizik dhe nuk ka detyrim të bëjë deklarimin për të ardhurat nga fitimi në shoqërinë e thjeshtë sipas pikës 8/g të ligjit nr.8438/1999 të ndryshuar dhe udhëzimit nr.5/2006 të ndryshuar nuk qëndron. Sipas pikës 2.3.3 të udhëzimit dhe nenit 8/g të ligjit nr.8438/1999 përjashtimin nga detyrimi për deklarimin e fitimit neto në deklaratën vjetore e kanë vetëm personat fizik tregtar. Në kuptim të nenit 2 të ligjit nr.8438/1999 dhe ligjit nr.9901/2008 të ndryshuar, ligjit nr.9723/2007 person fizik tregtar konsiderohet individ, që është i rregjistruar pranë organeve tatimore dhe qëndrës kombetare të Biznesit si person fizik. Pra personi fizik tregtar konsiderohet subjekti, i cili është i licenuar rregullisht personalisht për të ushtruar një veprimtari biznesi pranë organeve tatimore dhe në qëndrën kombëtare të rregjistrimit. Vetëm në këtë moment individit konsiderohet si person fizik tregtar. Duke iu rikthyer rastit në shqyrtim rezulton se kandidatja dhe anëtarët e tjerë të shoqërisë së thjeshtë nuk janë të rregjistruar personalisht si person fizik tregtar. Në këto kushte ata nuk kanë statusin e personit fizik tregtar sikurse arsyetohet shumica, por janë thjeshtë individë anëtar të një subjekti të të drejtës tregtare, që është i licensuar dhe rregjistruar rregullisht në Qendrën kombëtare të biznesit si shoqëri e thjeshtë. Kjo e fundit ka numër nipti të vecantë, administrator, kuota të pjesëmarrjes në fitime e në humbje të anëtarëve të saj të cilësuar si ortak etj. Pra rezulton se subjekti i vetëm i licensuar në ushtrimin e aktivitetit tregtar është shoqëria e thjeshtë dhe jo anëtarët e saj. Duke qënë se këto të fundit konsiderohen individë anëtar të shoqërisë dhe nuk gëzojnë statusin e personave fizik tregtar, pasi personalisht asnjë prej tyre nuk është i rregjistruar si i tillë në përputhje me ligjin, kandidatja nuk mund të pretendojë përjashtimin nga detyrimi për deklarimin e të ardhurave personale, pasi nuk figuron e rregjistruar si person fizik tregtar. Kandidatja nuk deklaron personalisht në emër të saj si person fizik bilance dhe as paguan tatimin mbi fitimin, pasi këto janë bërë nga shoqëria e thjeshtë, e cila figuron e rregjistruar në QKB dhe në organet tatimore ,si një subjekt tregtar me një personalitet të ndryshëm për mbartjen e të drejtave e detyrimeve para të tretëve dhe organeve tatimore nga ajo e anëtarëve të saj. Për aq kohë sa anëtari i shoqërisë së thjeshtë nuk është i rregjistruar si peson fizik tregtar, ai nuk mund të pretendojë të përfitojë nga parashikimet e nenit 8/g të ligjit nr.8439/1999 dhe nenit 2.3.3 të udhëzimit nr.5.

Megjithatë edhe në rast se anëtari do të barazohej me personin fizik tregtar sikurse arsyetohet shumica përsëri bashkimi i këtyre personave fizik do të konsiderohej si ortakëri në kuptim të nenit 2/iv të ligjit nr.8438/1999 dhe në përputhje me këtë cilësi secili prej tyre pra anëtarëve është i detyruar të deklarojë fitimin e marrë pas ndarjes sipas parashikimit të shprehur në nenet 4, 7, 8 të ligjit nr.8438/1999 dhe nenit 2.3.3 të udhëzimit nr.5/2006, ku përcaktohet detyrimi për

deklarim dhe tatim të të ardhurave të përfituara nga ndarja e fitimit në ortakëritë rezidente në Shqipëri.

Arsyetimi i shumicës se ortakëri sipas nenit 2/iv të ligjit nr.8439/1999 përfshin vetëm bashkimin e operatorëve ekonomik dhe se anëtarët e shoqërisë së thjeshtë kanë cilësinë e personave fizik nuk qëndron. Nën këtë llogjikë atëherë automatikisht bashkimi i personave fizik për ushtrimin e një veprimtari tregtare do e cilësonte marrëdhënien si ortakëri sipas nenit 2/iv të ligjit nr.8439/1999. Kështu neni 2/iv parashikon shprehimisht se; **një « ortakëri », si bashkim personash, fizikë dhe juridikë, për të kryer një veprimtari të përkohshme, të përbashkët me qëllim fitimi, që nuk krijohet si person juridik me vete në format e parashikuara nga ligji ”Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, nga Kodi Civil ose nga ligje të veçanta.** Në këtë drejtim anëtarët e shoqërisë së thjeshtë duhet detyrimisht të deklaronin të ardhurat e përfituara nga ndarja e fitimit.

Duke qënë se ligji “Për tatimin mbi të ardhurat personale” ka për qëllim të evidentojë të ardhurat e përfituara individualisht nga cdo person, atëherë ky ligj ka prioritet në zbatim dhe duhet interpretuar në mënyrë të tillë që të identifikojë të ardhurat e individit, me përjashtim të rastit kur idividi ka të njëjtin personalitet juridik e faktit me personin fizik tregtar. Në cdo rast të ndryshëm kur të ardhurat e individit vijnë nga ndarja e fitimit në një subjekt tregtar të licensuar qoftë si shoqëri e thjeshtë, ai duhet ti deklarojë këtë të ardhura, pasi konsiderohet fitime të realizuara nga bashkimi i tij me individ të tjerë në një biznes të vetëm për të realizuar fitime. Kuptimi i ortakërisë sipas nenit 2/iv të ligjit nr.8439/1999 i referohet edhe bashkimit të personave pasi ky subjekt rezulton i ndarë me presje nga cilësimi juridik dhe fizik, gjë që do të thotë se ortakëria është bashkim i këtyre subjekteve; a- personave, b-personave fizik, c-personave juridik, d-personave fizik dhe juridik midis tyre. Pra edhe në këtë drejtim shoqëria e thjeshtë si bashkim i personave individë konsiderohet një formë ortakërie, që realizon fitim si një operator ekonomik i vetëm. Fakti se ushtrimi i aktivitetit nuk kufizohet në një veprimtari të përkohëshme, por një veprimtari të mirëfilltë të rregjistruar si shoqëri e thjeshtë nuk përjashton deklarimin e të ardhurave të siguruar nga ndarja e fitimit të anëtares së shoqërisë së thjeshtë, pasi kjo shoqëri rregjistrohet në QKB sipas ligjit nr.9723/2007 të ndryshuar në mënyrë të vecuar nga personi fizik. Në rast se ligjvënësi do të kishte dashur të konsideronte shoqërinë e thjeshtë, si person fizik atëherë mund ta parashikonte një gjë të tillë në mënyrë të shprehur, gjë që nuk e ka bërë. Përkundrazi nenet 22 e 28 i ligjit nr.9723/2007 parashikojnë rregjistrimin e shoqërisë së thjeshtë si subjekt tregtar më vete dhe personat fizik më vete, gjë që do të thotë se shoqëria e thjeshtë dhe personi fizik nuk personifikojnë të njëjtën subjekt tregtar. Në rast se do të kishte këtë qëllim legjislatori bënte vetëm rregjistrimin e personave fizik dhe jo të shoqërive të thjeshta.

5-Nga shkresa e drejtuar Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nga Drejtoria e përgjithëshme e tatimeve përcaktohet se për anëtarët individë, që kanë formuar shoqërinë e thjeshtë, pjesa e fitimit pas taksimit të shoqërisë së thjeshtë nuk është listuar në mënyrë eksplicite në paragrafin 1 të nenit 13/2, ***por paragrafi g i nenit 13/2 kërkon që të përfshihen në deklaratën e të ardhurave edhe të ardhurat e tjera bruto, të papërmendura në pikën 1 të nenit.*** Më tej në këtë shkresë thuhet se; Në ligjin nr.9723 dt.03.05.2007 “Për rregjistrin e Bisnesit” i ndryshuar neni 22 paragrafi 1 pika b kërkon që; ***të rregjistrohen si entitet juridik edhe shoqëritë e thjeshta sipas dispozitave të kodit Civil. Pra ky ligj e trajton shoqërinë e thejshtë si entitet juridik të ndarë nga ortakët individë/personave fizik tregtar që e krijojnë shoqërinë e thjeshtë. Shoqëria e thjeshtë realizon fitim i cili taksohet si fitim i një entiteti juridik sipas dispozitave të ligjit Për tatimin mbi të ardhurat, ndërkohë që mbas fitimi mbas tatimit disponohet nga individët, që kanë themeluar shoqërisë e thjeshtë i cili në dispozitat e legjislacionit tatimor trajtohet si më sipër.*** Duke iu referuar kësaj shkrese rezulton se organet tatimore si organet kompetente të evidentimit dhe mbledhjes së tatimeve në Shqipëri kanë vlerësuar se individët anëtar të

shoqërisë së thjeshtë duhet të bëjnë deklarin në kolonën të ardhura të tjera bruto për fitimin e përfituar nga shoqëria e thjeshtë duke vlerësuar se kjo e fundit ka një personalitet tregtar të ndryshëm nga ajo e individëve, që e përbëjnë atë. Në këto kushte kandidatja duhet të kishte deklaruar rregullisht fitimin, që ajo kishte marrë nga shoqëria pas shpërndarjes në organet tatimore dhe ish-in këto të fundit që do të vlerësonin nëse ishte paguar apo jo tatimi për ndarjen e këtij fitimi apo duhet të tatohej në momentin e depozitimit të DIVA nga anëtarja e shoqërisë. Në rastin konkret kandidatja nuk e ka deklaruar me një diferencë të dukshme fitimin e përfituar nga shoqëria si e ardhur individuale në deklaratën individuale vjetore të të ardhurave (DIVA), duke iu shmangur në këtë mënyrë kontrollit tatimor të të ardhurave vjetore dhe më tej edhe pagimit të tatimeve. Kjo rrethanë është e mjaftueshme për të konkluduar se të ardhurat e përfituara nga kandidatja si ndarje e fitimit në shoqërinë e thjeshtë nuk konsiderohen të ligjshme, pasi nuk i janë nënshtruar vlerësimit dhe pagimit të tatimeve.

6- Nga ILDKPKI është konstatuar se referuar bilanceve të shoqërisë deri në 31.12.2018 shoqëria ka të pashpërndara shumën e fitimit prej 36 526 816 lekë , nga të cilat 34977 761 lekë fitimi i viteve të mëparëshme dhe 1 549 055 lekë fitim i vitit ushtrimor 2018. Ndërkohë kandidatja deklaroi se ka përfituar fitime në të gjitha vitet nga 2013-2018 në shumat respektive. Në kushtet kur shoqëria e thjeshtë nuk provohet të ketë shpërndarë ligjërisht fitimin e grumbulluar në vitet 2017, 2018 atëherë nuk provohet që fitimi i marrë nga anëtarja e shoqërisë të jetë pjesë e të ardhurave për të cilat është paguar fitimi, pasi ato rezultojnë të jenë gjëndje në shoqëri sipas bilanceve tatimore, që vetë shoqëria deklaroi në tatime.

Duke qënë se edhe vetë KED ka tagra të verifikojë dokumentacionin e ardhur për efekt të vlerësimit të ligjshmërisë së pasurisë së kandidatës, është konstatuar se në llogarinë bankare të saj me shënimin si fitim nga shoqëria vetëm për vitin 2018, kandidatja ka përfituar një shumë prej 45 000 euro në periudhën Mars deri në Shtator 2018 ndërkohë që fitimi i deklaruar për gjithë shoqërinë sipas bilancit në tatime është në vlerën fitim neto prej 1 549 055 lekë nga të cilat pjesa e kandidatës si ortakë është 154 906 lekë. Pra rezulton një diferencë e dukshme midis të ardhurave të përfituara nga kandidatja nën shënimin si fitim i shoqërisë në vitin 2018 dhe ato që në fakt ajo ka deklaruar si fitim të këtij viti nga shoqëria , madje edhe fitime të deklaruara nga vetë shoqëria në organet tatimore. Lidhur me këtë gjetje kandidatja ka sqaruar se fitimi, që ajo ka marrë në vitin 2018 i përket pjesërisht fitimeve të viteve të mëparëshme, që janë transferuar në llogari të saj në këtë vit. Mbi bazën e kësaj pyetje sqaruese kandidatja ka bërë një risistemim të të ardhurave të përfituara faktikisht prej saj ndër vite nga fitimi në shoqëri, sipas të cilave pranon se ka përfituar fitimet e viteve të mëparëshme, në vitet pasuese, por nuk ka paraqitur ndonjë vendim asambleje për shpërndarjen e fitimit. Ndërkohë nga dokumentat në tatime del se me vendimet e asamblesë së ortakëve janë miratuar pasqyrat e viteve financiare, por nuk rezulton të jenë depozituar vendime të ortakëve për shumat e shpërndara të fitimit nga llogaria e shoqërisë te ortakët. Kështu për vitin 2018 ose edhe për vitet e mëparëshme 2017, 2015 nuk rezulton të jetë bërë shpërndarje fitimi nga shoqëria, ndërsa kandidatja deklaroi të ardhura të krijuara nga fitimi i shoqërisë në llogarinë e saj si për vitin 2018 e për vitet e tjera. Prej saj u paraqitën vetëm mandate arkëtime, por jo vendime për ndarjen e fitimit të marrë nga anëtarët e shoqërisë dhe po ashtu nuk rezultonte që këto vendime për ndarjen e fitimit të ishin dorëzuar në QKB ose në organet tatimore.

Nga ana tjetër në deklaratën e saj individuale të të ardhurave vjetore deklarimi për të ardhurat e tjera të vitit 2018 është minimal prej 180 000 lekë, ndërkohë që në llogaritë bankare e ardhura e saj nga fitimi në shoqëri i gjeneruar në favor të saj në këtë vit është dukshëm më i lartë. Kandidatja duhet të deklaronte saktë të ardhurat e përfituara në vitin 2018 në deklaratën vjetore të këtij viti pavarësisht nëse fitimi i përkiste vitit 2018 apo viteve të mëparëshme, pasi në DIVA deklarohet të ardhurat e marra nga individë në vitin kur bëhet deklarimi. E njëjta gjë konstatohet edhe për vitet e mëparëshme sidomos 2016-2017. Nisur nga këto gjetje, në anëtarët

në pakicë vlerësojmë të drejta konstatimet e ILDKPKI se ka pasaktësi në deklaratimet e të ardhurave të fituara nga shpërndarja e fitimit në shoqëri, pasi nuk përputhet të dhënat e deklaruara në rubrikën e të ardhurave të tjera bruto në deklaratën vjetore të të ardhurave me ato të lëvruara faktikisht në secilin vit në llogari të saj si fitime nga shoqëria dhe gjithashtu nuk ka vendim për shpërndarjen e fitimit të shoqërisë për të konkluduar sasinë e të ardhurave të fituara nga kandidatja si ortakë dhe kohën e përfitimit saktësisht të tyre. Në këtë mënyrë nuk mund të konkludohet nëse për të ardhurat e lëvruara në llogari të kandidatës janë paguar rregullisht detyrimet tatimore, pasi vetëm të ardhurat e përfituara pas pagimit të detyrimeve tatimore konsiderohet të ligjshme.

7-Neni 33/1 i ligjit nr.8438/1998 i ndryshuar parashikon se;

Depozitimi i vendimit për miratimin e rezultatit vjetor dhe destinimi i fitimit

1. Shoqëritë tregtare, sipas ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, pas pagimit të tatimit mbi fitimin, sipas dispozitave të kreut III të këtij ligji, brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar, duhet të miratojnë në asamblenë e ortakëve apo organin kompetent vendimmarrës të shoqërisë rezultatet financiare të vitit paraardhës dhe ta destinonjë fitimin pas tatimit, duke përcaktuar shumën e rezervave ligjore, pjesën që do të përdoret për investime ose për shtesë kapitali dhe pjesën që do të shpërndahet në formë dividendi.

2. Shoqëritë tregtare dhe personat fizikë, sipas pikës 1 të këtij neni, duhet të depozitojnë pranë organeve tatimore, jo më vonë se data 31 korrik e vitit kalendarik, vendimin e organit përgjegjës/vendimin e personit fizik. Për paraqitjen me vonesë të këtij vendimi zbatohet një gjobë prej 10 000 (dhjetë mijë) lekësh për çdo muaj vonesë.

3. Personi juridik duhet të deklarojë dhe të paguajë për llogari të administratës tatimore tatimin mbi dividendin e pagueshëm, sipas pikës 1, të këtij neni, jo më vonë se data 20 gusht e vitit kur bëhet miratimi i rezultateve, pavarësisht nëse është bërë ose jo shpërndarja e dividendit. (Ndryshuar me Ligj Nr. 83/2014, datë 17.07.2014, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 126, datë 11 gusht 2014.)

4. Vendimi i asamblesë së ortakëve, i organit kompetent të shoqërisë/vendimi i personit fizik, sipas këtij neni, për miratimin e rezultatit dhe destinimin e fitimit pas tatimit, duhet të paraqitet në organin tatimor, në përputhje me afatin e përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, edhe nëse rezultati për vitin ushtrimor ka qenë me humbje apo zero. Për mosdepozitimin e vendimit zbatohen penalitetet, sipas pikës 2 të këtij neni. (Ndryshuar me Ligj nr.10228, dt. 4.2.2010, FL.Z. Nr. 13, dt. 25.02.2010.). (Ndryshuar (hequr fjalet) me Ligj nr. 39/2018, dt. 09.07.2018. Botuar në FL.Z. nr. 134, dt. 18 shtator 2018).

Sqarim- me ngjyrë të kuqe janë shënuar fjalët që janë hequr në ligj me ligjin nr.39/2018

Duke iu referuar kësaj dispozite del se edhe në rast se shoqëria e thjeshtë do të konsiderohet e barabartë për llogari të zbatimit të ligjeve tatimore me personin fizik, përsëri duhet të dorëzohej në drejtorinë e tatimeve vendimi i personit fizik për shpërndarjen e fitimit. Personi fizik është përjashtuar nga ky detyrim me ligjin nr.39/2018 i datës 09.07.2018, i cili ka herë në fuqi në datën 03.10.2018. E gjithë shuma prej 45000 euro e përfituar si fitim nga kandidatja rezulton e kaluar në llogari të saj në muajin Maj 2018 -25000 euro dhe në datën 10.09.2018 një shumë tjetër prej 20 000 euro. Pra të dy këto shuma janë lëvruar si fitim para se të përjashtohet personi fizik tregtar nga detyrimi i deklarimit dhe dorëzimit në tatime të shpërndarjes së fitimit sipas nenit 33/1 të ligjit nr.8438/1998 të ndryshuar. Kështu minimalisht nuk rezulton të jetë dorëzuar ndonjë vendim për shpërndarje fitimi deri në datën 31.07.2018 për shumën prej 25 000 euro të përfituar nga kandidatja para muajit Korrik të vitit 2018.

Kandidatja në pyetjet sqaruese shpjegoi se mënyra se si ajo kishte përfituar të ardhurat nga shpërndarja e fitimit ishte e ndryshme nga paraqitur paraprakisht në tabelën e analizuar nga ILDKPKI, ku referohet fitimi që i përkiste kandidatës në raport me kuotat e saj mbi çdo fitim

vjetor të shoqërisë. Në këtë mënyrë ajo prezantoi se kishte përfituar efektivisht një pjesë të fitimit të vitit 2014 në vitin 2015, atë të 2016 në vitin 2017, pjesërisht atë të vitit 2017 në vitin 2018. Megjithatë ajo nuk ka paraqitur ndonjë vendim të ortakëve për shpërndarjen e fitimit në periudhat, që ajo referon. Gjithashtu nga vetë ILDKPKI është konstatuar se subjekti nuk ka dorëzuar në organet tatimore vendim për shpërndarjen e fitimit në vitet 2015, 2017, 2018. Nisur nga këto rrethana nuk mund të konkludohet se të ardhurat që realisht janë lëvruar në llogarinë e kandidates në vite të jenë pjesë e të ardhurave për të cilat shoqëria e thjeshtë ka paguar tatimin mbi fitimin sipas bilanceve të saj. Për më tepër vetë kandidatja nuk i ka deklaruar ato në DIVA si të ardhura të tjera bruto. Prandaj për këto të ardhura, që ajo referon si pjesë nga fitimi i shoqërisë nuk provohet të jenë paguar as tatimi i fitimit, pasi shoqëria i ka ende të pashpërndara fitimet e realizuara në vitet 2015, 2017, 2018, në kundërshtim me sa pretendon kandidatja. Nga sa mësipër të paktën për shumat 45000 euro të derdhura në llogarinë e kandidates në vitin 2018 nuk provohet të jenë paguar nga shoqëria tatimi mbi fitimit dhe nuk provohet të jenë deklaruar më tej nga kandidatja në DIVA e vitit 2018. Mungesa e dokumentacionit ligjor për mënyrën si është përfituar fitimi i kandidates nga shoqëria, e bën të pajustificuar ligjshmërinë e të ardhurave. Duke qënë anëtare e shoqërisë ajo është në dijeni se ndarja e fitimit bëhet vetëm me vendimin e anëtarëve të shoqërisë dhe mungesa e këtij vendimi , i cili gjithashtu nuk është dorëzuar në organet tatimore, e bën të paligjshëm kalimit faktit të shumës së fitimit nga shoqëria në llogarinë personale të saj, pasi nuk provohet që kjo shumë të jetë përfituar nga shuma e fitimit e depozituar gjëndje në shoqëri, për të cilin është paguar tatimi i fitimit në vite. Prandaj nuk rezulton e provuar ligjshmëria e të ardhurave të përfituara prej 45000 euro nga kandidatja për vitin 2018 pasi nuk provohet të jenë paguar tatimet për to jo vetëm për tatimin mbi të ardhurat personale, por as për tatimin mbi fitimin, që paguhet nga shoqëria.

Për sa mësipër

Bazuar në nenin 235 të ligjit nr.115/2016 dhe piken 47 të vendimit nr.4/2019 të KED

Mendimi ynë është;

-Ndalimin e kandidimit të znj. Eris Hysi në vendin vakand të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

ANËTARE

Arta MARKU



ANËTARE

Vitore TUSHA



ANËTARE/RELATORE

Margarita BUHALI

